

# Raiffeisen Invest sh.a.

## Raport vjetor 2021

Raiffeisen Invest sh.a.  
Fondi i Investimit Raiffeisen Vizion  
Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj  
Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro  
Fondi i Investimit Raiffeisen Miks  
Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen

Ky raport nuk është një ofertë ose reklamë për shitjen e kuotave të fondeve të Raiffeisen INVEST.

Raporti vjetor përmban pasqyrat financiare të shoqërisë administruese dhe secilit prej fondeve për vitin 2021, të audituara nga shoqëria Deloitte Audit Albania sh.p.k.

---

Përmbajtje

<b>Mesazh nga Këshilli i Administrimit</b>	4
<b>Mesazh nga Administratorja e Përgjithshme</b>	5
<b>Raiffeisen Invest sh.a.</b>	7
Misioni dhe Vlerat	7
Qeverisja e Shoqërisë	8
Kodi i Etikës	9
Konflikti i Interesit	9
Transparenca	10
Procesi i Investimit	10
Burimet Njerëzore	12
<b>Përgjegjësia Sociale</b>	14
<b>Edukimi Fianciar</b>	16
<b>Raport i Menaxherëve të Fondeve</b>	18
Performanca e Fondeve – 31 Dhjetor 2021	18
Tarifa e vazhdueshme e Fondeve	18
Zhvillimet Ekonomike ..	19
Fondet gjatë vitit 2021 ..	20
<b>Fondi Raiffeisen Vizion</b>	22
Politika e Investimit	22
Performanca e Fondit	22
Top 10 - Investimet Kryesore si përqindje e asetëve	23
<b>Fondi Raiffeisen Prestigj</b>	24
Politika e Investimit	24
Performanca e Fondit	24
Top 10 - Investimet Kryesore si përqindje e asetëve	25
<b>Fondi Raiffeisen Invest Euro</b>	26
Politika e Investimit	26
Performanca e Fondit	26
Top 10 - Investimet Kryesore si përqindje e asetëve	27
<b>Fondi Raiffeisen Miks</b>	29
Politika e Investimit	29
Performanca e Fondit	29
Top 10 - Investimet Kryesore si përqindje e asetëve	29
<b>Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen</b>	30
Politika e Investimit	30
Performanca e Fondit	30
Top 10 - Investimet Kryesore si përqindje e asetëve	31
<b>Raport i Menaxherit të Riskut</b>	33
<b>Pasqyrat Financiare &amp; Raporti i Audituesit të Pavarur.</b>	38
Raiffeisen Invest sh.a – Shoqëria administruese	44
Fondi Raiffeisen Prestigj	72
Fondi Raiffeisen Invest Euro	74
Fondi Raiffeisen Vizion	77
Fondi Raiffeisen Miks	80
Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen	82

# Mesazh nga Këshilli i Administrimit

## **Të nderuar investitorë,**

Një vit tjetër i suksesshëm u mbyll për shoqërinë Raiffeisen Invest sh.a e cila vazhdon të jetë pranë jush si një shoqëri që kërkon gjithmonë mundësi të reja investimi me kthime të qendrueshme.

Ju falenderojmë për besimin e treguar ndër vite dhe bashkëpunimin tuaj të vazhdueshëm.

Kjo është e dukshme edhe në periudhat e krizave me të cilat janë përballur tregjet ndërkombëtare dhe ne në tregun vendas, si pasojë e efekteve negative të pandemisë.

Në vitin që lamë pas, ekonomia mbarë botërore filloi të tregojë shenja të rikuperimit duke dhënë shpresë dhe më tepër optimizëm në aspektet sociale dhe ato financiare. Këto shenja pozitive ecën paralel me kthime pozitive dhe të qendrueshme të fondeve të investimit dhe me kërkesë në rritje për investime të reja.

Ne si shoqëri jemi shumë të kënaqur me investitorët vendas të cilët gjithmonë e më tepër kanë shfaqur interes për alternativa të ndryshme investimi përveç atyre tradicionale. Kërkesat dhe njohuritë e tyre për të qenë sa më pranë tregjeve ndërkombëtare na nxisin për të qenë sa më inovatorë në treg, duke ofruar një gamë të gjerë produktesh financiare, në përshtatje të kërkesave të investitorit. Staf i shoqërisë Raiffeisen Invest mbetet gjithmonë i gatshëm për këshillime investimesh bazuar në kërkesat e investitorit, një bashkëpunim ky që ndër vite ka qenë dhe vazhdon të jetë i frytshëm.

Diversifikimi i fondeve në tregjet ndërkombëtare të kapitalit ka qenë dhe vazhdon të jetë objektivi ynë për të ofruar produkte me standard të lartë, bazuar në strategjinë e shoqërisë.

Secili fond nën administrim të shoqërisë, ofron një mundësi për investime profesionale në instrumenta të kapitalit duke i dhënë zhvillim tregut të kapitaleve në vendin tonë. Zhvillimet e fundit tregojnë që tregu vendas po vazhdon përjasjen drejt tregjeve ndërkombëtare të strukturuar i mbështetur gjithashtu edhe nga kuadri ligjor dhe rregulloret përkatëse të hartuara nga Autoriteti lokal për tregjet e kapitalit.

Ofrimi i shërbimit të investimit në fonde nëpërmjet kanalit dixhital ishte një tjetër sukses për shoqërinë, shërbim ky që pati një rritje të konsiderueshme përgjatë vitit. Investimi nëpërmjet kanalit dixhital i ofron investitorit ekzistues mundësinë që të rrisë e të diversifikojë portofolin e investimit vetëm me një klikim kudo që ndodhet. Shoqëria Raiffeisen Invest vazhdon të jetë inovatore në tregun lokal duke investuar në teknologji për të ecur me hapin e kohës dhe për të ofruar shërbime dhe produkte cilësore.

Në emër të Këshillit të Administrimit falenderoj secilin nga investitorët që është pjesë integrale në këtë sipërmarrje të madhe. Produktet me standarde të larta dhe shërbimi transparent do të jenë gjithmonë pjesë e misionit tonë.

Ju faleminderit!

## **Në emër të Këshillit të Administrimit**

Donalda Gjorga

Kryetare



# Mesazh nga Administratorja e Përgjithshme

## Të nderuar Investitorë!

Viti 2021 ishte një vit i suksesshëm, por mjaft sfidues si për investitorët ashtu edhe njerëzit tanë. Ne operuam në një mjedis tregu tepër dinamik, ku në fokus kryesor ishin investitorët e fondeve dhe ia dolëm që t'u ofrojmë rezultate shumë të mira si atyre ashtu edhe aksionerëve tanë.

Ndërsa lamë pas vitin 2021, dua të falënderoj veçanërisht të gjithë punonjësit e Raiffeisen Invest. Me krenari mund të them se kemi një skuadër e cila falë punës së palodhur dhe përkushtimit ka qenë motor i padiskutueshem i çdo suksesi deri më sot.

Njerëzit tanë janë vazhdimisht të fokusuar në zbatimin e praktikave më të mira të menaxhimit të aseteve, duke qenë plotësisht transparentë me klientët.

Për më tepër, gjatë një viti jo të lehtë pandemie, ata mobilizuan forcat dhe ekspertizën për të mbështetur investitorët në çdo moment dhe në një mjedis sfidues siç ishte puna në distancë.



Gjatë vitit 2021, Raiffeisen Invest ruajti pozicionin e shoqërisë lider në tregun shqiptar për fondet e investimeve, me 94 përqind të këtij tregu.

Asetet nën menaxhim njihën një rritje të fortë krahasuar me vitin 2020 (+ 17%), duke arritur një total prej afërsisht 613 milionë euro në fondet e investimeve dhe te pensionit vullnetar (604.7 milionë euro në fondet e investimeve dhe 8.6 milionë euro në fondin e pensionit). Numri i investitorëve që na besuan menaxhimin e aseteve të tyre ishte 38,420 investitorë për fondet e investimeve (ose +22% në raport me vitin 2020) dhe 3,220 investitorë për fondin e pensionit vullnetar (ose +3,3% krahasuar me vitin 2020).

Pavarësisht luhatshmërisë së tregjeve financiare, viti 2021 ishte një vit rimëkëmbjeje për ekonominë globale, i karakterizuar nga politika monetare akomoduese nga bankat qendrore. Performanca e fondeve nën administrim ishte e kënaqshme në kushtet e një mjedisi financiar sfidues.

Viti 2021 ishte gjithashtu një vit i mbarë për sa i përket disa nismave strategjike. Ne bëmë një hap më tej drejt transformimit dixhital të biznesit përmes përmirësimeve të "Modulit të Investimeve" në platformën Raiffeisen ON, rritëm peshën e shitjeve nëpërmjet kanaleve digjitale krahasuar me vitin 2020 dhe vazhduam të jemi e vetmja kompani administruese në treg që ofron shërbime digjitale për klientët e saj.

U realizua gjithashtu një projekt i rëndësishëm: përshtatja e veprimtarisë së Raiffeisen Invest dhe të gjithë fondeve nën administrim me kërkesat e kuadrit të ri ligjor për sipërmarrjet e investimeve kolektive.

Viti 2021 ishte gjithashtu një vit progresi për sa u takon disa iniciativave strategjike të mëparshme siç janë planet e investimit, duke arritur në 7223 plane aktive (kryesisht në Lekë), ose +120% kundrejt vitit 2020.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, si një shoqëri administruese e Grupit RBI, Raiffeisen Invest ka integruar konceptin e qendrueshmërisë në strategjinë e saj të zhvillimit me qëllimin për ta kthyer në një element të rëndësishëm të politikës së biznesit. Për ne, qendrueshmëria shihet si përgjegjësi e korporatës për të arritur suksese ekonomike afatgjata duke respektuar mjedisin dhe shoqërinë. Sot, kujdesi për njerëzit dhe mjedisin dhe përdorimi i përgjegjshëm i burimeve janë më të rëndësishme se kurrë. Raiffeisen Invest synon të jetë një shoqëri që merr parasysh këto aspekte gjatë aktivitetit të saj dhe të kontribuojë kështu në zhvillimin e një bote të qendrueshme përmes lançimit të produkteve ESG në një të ardhme të afërt.

Viti 2022 pritet të jetë një vit sfidues, i karakterizuar nga inflacion i lartë e politika monetare shtrënguese dhe me perspektivë në ngadalësim të rritjes ekonomike pothuaj në të gjithë botën.

Në Shqipëri, inflacioni do të jetë në rritje, i importuar kryesisht nga jashtë. Normat e interesit të letrave me vlerë të qeverisë do të rriten në përgjigje të rritjes së inflacionit, por tendenca e yield-eve do të varet nga nevojat për financim të qeverisë dhe niveli i likuiditetit në treg.

Gjatë vitit të ardhshëm, Raiffeisen Invest do të jetë e fokusuar në transformimin digjital dhe në lançimin e produkteve të qendrueshme, duke synuar të jetë një pionier i transformimit digjital dhe qendrueshmërisë në tregun shqiptar të fondeve të investimeve. Vizioni ynë do të mbetet ofrimi i një shërbimi me cilësi të lartë për klientët si dhe të jemi shoqëria më e rekomanduar e menaxhimit të aseteve në treg.

Në përfundim, dua t'ju falenderoj të gjithëve ju për besimin tuaj, duke ju garantuar që biznesi ynë i menaxhimit të fondeve do të vijojë të mbështetet në integritet dhe transparencë.

**Edlira Konini**

**Administratore e Përgjithshme**



# Rreth Raiffeisen Invest Sh.a

Raiffeisen Invest sh.a është shoqëria e l-rë e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për administrimin e fondeve të pensionit vullnetar & sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Edhe gjatë vitit 2021, Raiffeisen Invest sh.a vazhdoi të ruante pozicionin e shoqërisë lider në tregun financiar shqiptar në fushën e administrimit të aseteve, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë kujdesit ndaj investitorëve, transparencës dhe përkushtimit në shërbimin ndaj tyre si dhe zbatimit të standardeve dhe praktikave më të mira.

Gjatë vitit 2021, në fokus ishte gjithashtu finalizimi i procesit të përshtatshmërisë së aktivitetit të shoqërisë dhe fondeve nën administrim me kuadrin e ri ligjor të miratuar lidhur me sipërmarrjet e investimeve kolektive;

Raiffeisen Invest sh.a, gjatë vitit 2021 kishte nën administrimin e saj katër (4) fonde investimi, përkatësisht Fondet Raiffeisen Prestigj dhe Raiffeisen Vizion në lekë, Raiffeisen Invest Euro dhe Raiffeisen Miks në monedhën euro, si dhe 1 (një) fond pensioni vullnetar në lekë: Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen;

Totali i aseteve nën administrim të Raiffeisen Invest sh.a në fund të vitit 2021, ishte 74,059,248,383.99 lekë.

## Misioni dhe Vlerat

### Misioni:

T'u ofrojmë investitorëve tanë një eksperiencë të shkëlqyer, nëpërmjet alternativave të reja dhe të përshtatshme të investimit dhe teknologjive inovatore, bazuar në parime dhe profesionalizëm, nëpërmjet fokusimit dhe jo vetëm në:

- Njohjen e klientëve tanë dhe orientimin e tyre drejt vendimarrjes së duhur të investimit;
- Administrimin cilësor të aseteve me qëllim kthime të kënaqshme nga investimi;
- Mirëqeverisjen e korporatës;
- Krijimin e opsioneve të reja për investim, paralelisht me rritjen e edukimit financiar të publikut mbi fondet e investimit & pensionit vullnetar.

### Vlerat:

**Integritet:** Ne vendosim interesat e klientëve tanë në plan të parë, duke i bërë qëllimet e tyre qëllimet tona. Ky është detyrimi ynë etik dhe profesional - dhe mënyra e duhur për të vepruar. Integriteti është thelbi i procesit tonë të investimeve, marrëdhënieve me klientët dhe gjithçka që bëjmë.

**Përgjegjshmëri:** Veprojmë me përgjegjësi ndaj investitorëve, njëri-tjetrit dhe komunitetit. Vetëm dhe së bashku jemi përgjegjës për çdo vendim e veprim që ndërmarrim.

**Të mësuarit:** I gjithë stafi ynë është në një proces mësimi të vazhdueshëm me qëllim arritjen e nivelit më të lartë të profesionalizmit dhe praktikave më të mira të administrimit të aseteve.

**Bashkëpunim:** Në Raiffeisen Invest ne kemi krijuar një mjedis të ngrohtë ku bashkëpunojmë, komunikojmë dhe mbështesim njëri-tjetrin nëpërmjet besimit dhe respektit reciprok.

**Disiplinë:** Ajo që na udhëheq në çdo proces analize, pune kërkimore dhe investime është disiplina. Ne i përmbahemi një procesi të qëndrueshëm dhe të disiplinuar, duke u siguruar që çdo vendim të mbështetet në një gjykim të shëndoshë, pa u shpërqendruar nga skupe mediatike dhe mentaliteti i turmës. Ky fokus na mundëson marrjen e vendimeve racionale në një kohë kur investitorët shpesh bëjnë vendimarrje emocionale.

# Qeverisja e Shoqërisë

Raiffeisen INVEST sh.a është shoqëri aksionere, e organizuar sipas sistemit me një nivel drejtimi, në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14/04/2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

Selia e shoqërisë është në Rr.Tish Daija,Kompleksi Kika 2, Tiranë, Shqipëri.

Aksioneri i vetëm i shoqërisë është Raiffeisen Bank sh.a.

Organet drejtuese të shoqërisë janë: Asambleja e Aksionerëve, Këshilli i Administrimit dhe Administratorët Ekzekutivë.

## 1. Asambleja e Aksionerëve

Asambleja e aksionerëve përbëhet nga përfaqësuesit ligjorë të aksionerit të vetëm të shoqërisë Raiffeisen Bank sh.a.

## 2. Këshilli i Administrimit

Këshilli i Administrimit është organi qendror i Shoqërisë Raiffeisen Invest sh. a, i cili kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit.

### 2.1 Përbërja:

Kryetare	<b>Znj. Donalda Gjorga</b> Chief Dealer - Departamenti i Thesarit - Raiffeisen Bank sh.a, Shqipëri
Nën kryetar	<b>Z. Peter Zilinek</b> Drejtor për Steering në Departamentin EQL - Raiffeisen Capital Management, Austri.
Anëtare	<b>Znj. Vilma Baçe</b> Drejtoresh e Divizionit të Shitjeve dhe Rrjetit Shpërndarës - Raiffeisen Bank sh.a, Shqipëri
Anëtare	<b>Znj. Alda Shehu</b> Drejtoresh e Departamentit të Strategjisë dhe Inovacionit - Raiffeisen Bank sh.a, Shqipëri
Anëtar	<b>Z. Joan Canaj</b> Drejtor i Divizionit të Riskut të Integruar - Raiffeisen Bank sh.a, Shqipëri
Anëtare	<b>Znj. Edlira Konini</b> Administratore e Përgjithshme - Raiffeisen Invest sha, Shqipëri
Anëtare	<b>Znj. Alketa Emini (Gjoçaj)</b> Zv/Administratore e Përgjithshme - Raiffeisen Invest sh.a, Shqipëri

## 3. Komiteti i Investimeve

Vendimarrja në procesin e rëndësishëm të investimit si dhe mbikëqyrja e këtij procesi i është besuar Komitetit të Investimeve. Komiteti i Investimeve është një organ kolegjal, vendimarrës dhe mbikëqyrës. Ai monitoron nëse procesi i investimit është në përputhje me politikën e investimit të secilit fond të miratuar nga Këshilli i Administrimit, si dhe në përputhje me politikën e administrimit të riskut dhe kërkesat rregullatore.

### 3.1 Përbërja në vitin 2021

1. Nënkryetari i Bordit Drejtues (RBAL)	Kryetar
2. Anëtari i Bordit për Retail (RBAL)	Anëtar
3. Drejtori i Departamentit të Riskut të integruar (RBAL)	Anëtar
4. Drejtori Divizionit të Manaxhimit të E-banking (RBAL)	Anëtar
5. Administratori i Përgjithshëm (RIAL)	Anëtar
6. Zv/ Administratori i Përgjithshëm (RIAL)	Anëtar
7. Drejtori i Manaxhimit të Fondeve (RIAL)	Anëtar
8. Drejtori i Manaxhimit të Riskut	Anëtar

Oficeri i Përputhshmërisë merr pjesë dhe monitoron çdo mbledhje të Komitetit të Investimeve. Komiteti i Investimeve zhvillon mbledhje të rregullta, të paktën 1 herë në muaj.



## 4. Ekipi Drejtues i Raiffeisen Invest sh.a

**Znj. Edlira Konini**  
Administratore e Përgjithshme

**Znj. Alketa Emini (Gjocaj)**  
Zv/Administratore e Përgjithshme

**Z. Lizandër Saraçi**  
Drejtor i Departamentit të Menaxhimit të Riskut

**Zj. Rezarta Arapi**  
Drejtoresh e Menaxhimit të Fondeve

**Znj. Brunilda Haxhimihali (Emini)**  
Drejtoresh e Departamentit Ligjor, Përputhshmërisë & PPP

## Kodi i Etikës

Në ushtrimin e aktivitetit të administrimit të aseteve Raiffeisen Invest sh.a, bazohet në legjislacionin shqiptar si dhe udhëhiqet nga Kodi i Etikës së Grupit Raiffeisen.

Kodi i Etikës së Grupit Raiffeisen përshkruan vlerat e përbashkëta dhe standardet bazë të sjelljes etike në biznes, që duhet të ndiqen nga të gjithë shoqëritë e Grupit. Ai udhëheq veprimtarinë e përditshme me të gjitha palët, brenda dhe jashtë shoqërisë.

Kryerja e veprimtarisë tregtare në mënyrë etike, të ligjshme dhe me përgjegjshmëri të lartë është thelbi i kulturës së shoqërisë Raiffeisen Invest sh.a.

Kodi i Etikës Raiffeisen është i detyrueshëm për çdo punonjës, dhe ka si qëllim të sigurojë që sjellja në marrëveshjet e biznesit dhe çëshjet e etikës të jetë në përputhje me standardet tona të larta. Standardet bazohen në vlerat në vijim :

- **Orientimi ndaj Klientit ;**
- **Profesionalizmi ;**
- **Cilësia ;**
- **Respekti reciprok ;**
- **Iniciativa ;**
- **Puna në grup ;**
- **Integriteti ;**
- **Qeverisja e mirë e korporatës**

## Konflikti i Interesit

Çdo punonjës i Raiffeisen Invest sh.a është i përkushtuar për të identifikuar dhe shmangur konfliktin potencial të interesit gjatë ushtrimit të detyrave.

Anëtarët e Komitetit të Investimeve si dhe të Këshillit të Administrimit duhet të deklarojnë çdo konflikt të mundshëm interesi.

Të gjithë punonjësit duhet të sigurojnë që interesat e tyre nuk bien në konflikt me detyrimet e tyre ndaj shoqërisë apo me detyrimet e shoqërisë ndaj investitorëve.

Në veçanti punonjësit e përfshirë në procesin e investimit të aseteve nuk duhet të kenë paralelisht një aktivitet apo biznes personal, i cili mund të jetë në konflikt me administrimin e investimeve në mënyrën e duhur, apo që mund të kufizojë aftësinë e tyre për të marrë vendime të paanshme.

Raiffeisen Invest sh.a ka në strukturën e saj organizative Njësinë e Përputhshmërisë, një nga detyrat e veçanta të së cilës është parandalimi, identifikimi dhe administrimi i konflikteve të interesit midis shoqërisë dhe fondeve të saj, si dhe ndërmjet fondeve në mënyrë që të sigurohet që investitorët të mos jenë në disavantazh përmes konflikteve të interesit.

# Transparenca

Një nga parimet më të rëndësishme ku bazohet veprimtaria e Raiffeisen Invest sh.a, është Transparenca ndaj Investitorit. Faqja zyrtare e shoqërisë, e cila përditësohet dhe mirëmbahet vazhdimisht luan një rol të rëndësishëm në informimin e investitorëve dhe publikut. Në web-site të shoqërisë publikohen periodikisht të gjitha raportet e ndërmjetme dhe vjetore të shoqërisë dhe të gjitha fondeve nën administrim, raporte mujore për çdo fond si dhe informacione të përditësuara rreth fondeve dhe dokumentacionit të tyre, mënyrës së investimit në fond, publikimi i çmimit të kuotës çdo ditë etj. Çdo investitor mund të aksesojë në çdo kohë llogarinë personale në fond, duke u njohur me ecurinë e investimit të tij dhe të ketë mundësi të marrë vendime në kohën e duhur.

Ndërkohë, stafi i Raiffeisen Invest sh.a., është në komunikim të vazhdueshëm me investitorët si nëpërmjet e-mail apo telefonatave duke sqaruar çdo pyetje apo kërkesë që lidhet me investimin e tyre.

# Procesi i Investimit

Administrimi i portofolit bëhet duke implementuar "Rregullin e personit të kujdesshëm". Ky rregull detyron administratorët e fondeve që të veprojnë dhe të investojnë me të njëjtin gjykim, kujdes e mençuri, me të cilin do të vepronte një person i kujdesshëm që po administron asetet e tij, jo për motive spekulimi, por për një motiv të pastër investimi, duke konsideruar mundësitë e ruajtjes së kapitalit dhe mundësinë e të ardhurave që do të fitonte si rezultat i këtij investimi.

Fondet e administruara nga Raiffeisen Invest sh.a., administrohen nga profesionistët më të mirë në treg, me "kujdesin e duhur", të denjë për besimin e publikut dhe me motiv të pastër investimi, duke konsideruar mundësitë e ruajtjes së kapitalit dhe të ardhurave potenciale si rezultat i këtij investimi.

# TRE TENORET

## 20 Vjet

### TRE TENORËT

*Arnaldo Klloçjari*  
*Ignacio Encinas*  
*Fabio Andreotti*

### TRE SOPRANOT

*Me qelë manjën e pasthënkondime*

*Insa Mula*  
Soprano Floëre  
*Simona Pasarelli*  
*Ramona Tullumani*

### TRE MUSKËTJERËT

*Aleksandër Gjoka*  
*Redon Makashi*  
*Elton Deda*

### ORKESTRA FILARMONIKE "TRE TENORET"

Dirigjent: *Leonardo Quadrini*

I ftuar

*Genç Tubiçi* Piano

DREJTOR ARTISTIK

*Arian Paço*

DREJTOR ORGANIZATIV

*Lorenç Radovani*

PRODUCENT

*Edmond Tullumani*



*Ejani të festojmë së bashku*

24 SHTATOR 2021

AMFITEATRI I TIRANES

Ora: 19.00

Sponsor Gjeneral



Biletat mund të blini online tek: [www.myticket.al](http://www.myticket.al) Tel: +355 6740 55 500, [info@myticket.al](mailto:info@myticket.al)  
si dhe pranë Amfiteatrit të Tiranës nga data 20 - 24, Shtator 2021

# Burimet Njerëzore

Burimet njerëzore luajnë një rol shumë të rëndësishëm në implementimin e strategjisë së Raiffeisen Invest sh.a, si dhe në arritjen e objektivave të shoqërisë ; Eksperienca dhe zhvillimi profesional i burimeve njerëzore është në fokusin kryesor të shoqërisë.

Raiffeisen Invest sh.a. ka një skuadër me ekspertët më të mirë në tregun shqiptar të kapitalit, me nivel shumë të mirë edukimi, si dhe përvojë në sektorin financiar. Ata janë të përkushtuar, me standarde të larta etike dhe me një zhvillim tepër dinamik profesional të mbështetur në KnowHow të Grupit Raiffeisen.

Shoqëria në fund të vitit 2021 kishte 15 punonjës me kohë të plotë.

Edhe gjatë vitit 2021, shoqëria mbështeti zhvillimin profesional të stafit të saj, përmes trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm.

Trajnimet janë zhvilluar përmes platformave që sigurojnë zhvillimin e moduleve të trajnimit online, duke u shoqëruar me testimin e njohurive të marra, përpara certifikimit të stafit pjesëmarrës.

Në kuadrin e trajnimeve të marra nga stafi i RIAL mund të përmendim trajnimet me temat si "Parandalimi i Pastrimit të Parave, Përputhshmëria dhe Menaxhimi i Krimet Financiar", "Sistemi i Kontrollit të Brendshëm", "Privatësia e të dhënave & Qeverisja e cilësisë së tyre" "Mënyra e re e të punuarit & Siguria e informacionit", "Masat për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në RIAL", "Risku Operacional", etj.

 Raiffeisen  
INVEST

4th Edition



BORSH, ALBANIA

**SOUTH  
OUTDOOR  
FESTIVAL**  
Unforgettable

3-6 SEP 2021



Mundësuar nga:

 Raiffeisen  
INVEST

Creative Partner

 MANIA  
CARD  
SM&F COMMUNICATIONS

# Përgjegjësia Sociale

Raiffeisen Invest sh.a, edhe gjatë vitit 2021, vijoi me angazhim maksimal të mbështesë komunitetin dhe shoqërinë në Shqipëri, duke përmbyshur një nga elementët e rëndësishëm të misionit të saj, që është përgjegjësia sociale.

Gjatë këtij viti, Raiffeisen Invest sh.a mbështeti 60 projekte në të gjithë Shqipërinë duke u fokusuar kryesisht në projektet që lidhen me kujdesin shëndetësor, përmirësimin e kushteve në spitale dhe qendra shëndetësore, financimin e pajisjeve kompjuterike për një sërë institucionesh arsimore të të gjitha niveleve, por pa lënë pas edhe mbështetjen e projekteve sociale si dhe promovimin e sportit, kulturës si dhe mbrojtjes së mjedisit.

Mund të përmendim projektet "Blerja e pajisjeve spitalore për Repartin e Maternitetit të Spitalit të Lezhës", "Blerja e pajisjeve për Qendrën Shëndetësore Krujë" "Rikonstruksioni i Shërbimit të Kirurgjisë për Klinikën Stomatologjike Tiranë" "Pajisje Echo për Spitalin e Shkodrës", "Instalimi i sistemit të kondicionimit në pavijonet e Spitalit të Sarandës etj.

Edukimi mbetet një nga shtyllat kryesore të një shoqërie të qëndrueshme, ndaj Raiffeisen Invest mbështeti edhe mjaft projekte në fushën e arsimit. Vlejnë të përmenden projektet e zhvilluara nga Qendrat Arsimore në Berat, Vlorë, Gjirokastër, Sarandë, si dhe Universiteti i Durrësit, Universiteti Fan S. Noli në Korçë, etj. lidhur me blerjen e pajisjeve të nevojshme për institucionet e arsimit, si dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore në funksion të procesit të edukimit. Gjithashtu, vlen të përmendet dhënia e bursave për 150 fëmijë në nevojë, projekt ky i Bashkisë Tiranë në bashkëpunim me Qendrën Tumo si dhe pajisja e Institucionit të Fëmijëve të Verbër me pajisje audio të teknologjisë më të fundit për të krijuar librarinë e tyre audio.

Një kontribut i rëndësishëm i është dhënë projektit "Pastrimi i bregdetit përpara fillimit të sezonit turistik", me të cilin promovojmë rëndësinë e mbrojtjes së natyrës në vendin tonë.

Në fushën e artit dhe kulturës, janë mbështetur një sërë aktiviteteve artistiko-kulturore siç janë Koncerti '3 Tenorët', "Festivali i muzikës Jazz edicioni i 10-të " "ZA Fest, edicioni i 5-të", "Festivali Ndërkombëtar i filmit dokumentar dhe të shkurtër" "Dardan Fest 2021" etj.

Raiffeisen Invest sh.a, si pjesë e një grupi të madh dhe shoqëri lider në treg, tashmë e ka përfshirë përgjegjësinë sociale si pjesë të misionit të saj, duke vijuar me përkushtim dhe dedikim të kontribuojë me të gjitha shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm.





## “Talenti i lagjes”

**23 gusht**

pranë poliklinikës nr.10 dhe shkollës Gjon Buzuku  
në fushën mes pallateve parafabrikat

**24 gusht**

përballë Maternitetit të Ri  
pranë zonës së Brçyllit

**25 gusht**

në fushën e Ali Demit

**26 gusht**

pranë shkollës Naim Frashëri  
në zonën e ish klubit Partizani

**27 gusht**

në zonën e Freskut  
pranë Thesarit të Bankës së Shqipërisë



Në secilin prej këtyre vendeve aktiviteti do të zhvillohet i ndarë në dy pjesë,  
paradite nga ora 09:30 deri në 11:30 si dhe pasdite nga ora 17:30 deri në 19:30.



# Edukimi financiar

Raiffeisen Invest sh.a. gjithmonë e ka konsideruar edukimin financiar të publikut si tejet të rëndësishëm për zhvillimin e tregut të fondeve të pensionit dhe investimit por jo vetëm, edhe për zhvillimin e tregut të kapitalit në tërësi; Edukimi dhe kultura financiare si dhe ndërgjegjësimi i publikut për nevojën e tyre, padyshim që nxit ofertën e një game sa më të gjerë produktesh financiare, në përputhje me horizontin e investimit dhe profilin e riskut të investitorëve dhe kuadrin ligjor e rregullator në fuqi.

Duke e renditur si një nga objektivat strategjikë të shoqërisë, edhe gjatë vitit 2021, Raiffeisen Invest sh.a publikoi në faqen zyrtare dhe në mediat sociale një sërë materialesh informuese dhe edukuese lidhur me zhvillimet në tregjet financiare dhe impaktin që ato patën nga pandemia, karakteristikat e fondeve, përfitimet nga investimi etj. Gjithashtu, Raiffeisen Invest sh.a ka mbështetur një sërë projektesh për promovimin e edukimit dhe ndërgjegjësimit financiar veçanërisht te të rinjtë, ku mund të përmendim: "Edukimi financiar në epokën digjitale"; "Rritja e ndërgjegjësimit për pagesat digjitale"; "Njihuni me paranë" etj.

Në 1 Nëntor, Ditën Ndërkombëtare të Kursimit, Raiffeisen Invest realizoi një aktivitet me pjesëmarrjen e studentëve nga disa universitete të Shqipërisë, ku u prezantuan mënyra të thjeshta kursimi siç janë planet e investimit apo fondet e pensionit vullnetar, me qëllimin e ndërgjegjësimit të të rinjve për një mirëadministrim të financave personale përmes kursimit dhe investimit.





**1 Nëntor**  
ora 15.00

 **Raiffeisen  
INVEST**



## **Dita Ndërkombëtare e Kursimit**

Diskutim i hapur mbi Fondet e Investimit dhe Pensioneve  
nga Edlira Konini - CEO Raiffeisen Invest

# Raport i Menaxherëve të Fondeve

## Performanca e Fondeve në 31 Dhjetor 2021

Kthimi neto nga investimi	Raiffeisen Prestigj	Raiffeisen Vizion	Raiffeisen Invest Euro	Raiffeisen Miks	Raiffeisen Pension
1 vit (kthimi në bazë vjetore periudha 31.12.2020 - 31.12.2021)	2.43%	4.43%	-1.00%	4.68%	4.44%
3 vjet (kthimi në bazë vjetore periudha 31.12.2018 - 31.12.2021)	1.72%	3.15%	0.49%		4.56%
5 vjet (kthimi në bazë vjetore periudha 31.12.2016 - 31.12.2021)	2.65%		0.50%		5.00%
Që nga krijimi i fondit (kthim me bazë vjetore)	4.72%	3.54%	1.71%	4.50%	6.36%

\*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Çmimi i Kuotës së Fondeve për 3 vitet e fundit	Raiffeisen Prestigj	Raiffeisen Vizion	Raiffeisen Invest Euro	Raiffeisen Miks	Raiffeisen Pension
Më 31.12.2021	1,574.3746	1,122.8965	116.7439	104.6895	1,971.6047
Më 31.12.2020	1,537.0592	1,075.2578	117.9191	100.0123	1,887.7529
Më 31.12.2019	1,524.4146	1,057.0721	119.6055		1,809.1211

## Tarifa e vazhdueshme e Fondeve

	Raiffeisen Prestigj	Raiffeisen Vizion	Raiffeisen Invest Euro	Raiffeisen Miks	Raiffeisen Pension
Tarifa e vazhdueshme në 31.12.2021	1.25%	1.25%	1.49%	1.55%	1.50%

# Zhvillimet Ekonomike

Viti 2021 shënoi një vit kthese dhe rimëkëmbjeje në terma ekonomikë dhe socialë pas një viti 2020 shumë të vështirë, në të cilin nisi pandemia botërore e shkaktuar nga Covid-19. Vaksinimi i shpejtë i popullsisë dhe kontrolli i pandemisë ishin gjithashtu kontribues të rëndësishëm në rezultatet pozitive ekonomike. Në përgjithësi 2021 ishte një vit rimëkëmbjeje mbresëlënëse për ekonominë globale dhe u karakterizua nga politika monetare lehtësuese nga ana e Bankave Qendrore. Ekonomia shqiptare gjithashtu u rrit ndjeshëm me 8.54 përqind. Kjo rritje ekonomike u mbështet kryesisht nga politikat fiskale, rritja e investimeve dhe konsumi vendas.

Aktiviteti i fondeve të Raiffeisen Invest u zhvillua në një mjedis ekonomik sfidues në tregun e brendshëm dhe të jashtëm financiar, por rezultatet e fondeve ishin të kënaqshme dhe reflektuan zhvillimet në tregjet financiare.

Normat e interesit të titujve të borxhit të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në të cilat investojnë fondet në Lekë, vijuan të jenë në nivele të ulëta duke shënuar një prirje rënëse krahasuar me vitin e mëparshëm. Edhe në tregjet ndërkombëtare Yield-et e obligacioneve shënuan rënie deri në fund të tremujorit të tretë, të mbështetura nga programet e blerjes së obligacioneve të Bankave Qendrore. Më pas, ato regjistruan një prirje të mprehtë rritëse gjatë tremujorit të fundit të 2021 për faktin se rritja e presionit inflacionist në nivel global rezultoi të ishte shumë më tepër se një episod "kalimtar".

Rritja e inflacionit u shkaktua nga rihapja e shpejtë ekonomike nga njëra anë dhe nga rritja e çmimeve të produkteve jetësore si naftë, gaz ose energji nga ana tjetër. Në përgjithësi niveli i kërkesës u ringjall fuqishëm këtë vit, por në shumë fusha, oferta ishte e pamjaftueshme për të mbajtur ritmin. Edhe në Shqipëri inflacioni shënoi rritje të konsiderueshme nga 0.4 përqind në Janar 2021 në 3.7 përqind në Dhjetor, duke kapërcyer nivelin 3 përqind që është objektivi i vendosur nga Banka e Shqipërisë.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë doli në tregjet ndërkombëtare duke emetuar një Eurobond 10 vjeçar me yield 3.75 përqind për shumën 650 milionë euro në muajin Nëntor dhe në tregun vendas zgjeroi maturitetin e emetimeve duke emetuar për herë të parë obligacion qeveritar 15 vjeçar me normë interesi 5.88 përqind.

Vlerësimi i agjencive në lidhje me borxhin e Qeverisë Shqiptare qëndroi i pandryshuar në nivelin B1 nga Moody's dhe B+ nga "Standard & Poors" me një parashikim të qëndrueshëm.

# Fondet gjatë vitit 2021

Ecuria e tregjeve financiare ndërkombëtare u karakterizua nga luhatshmëri e lartë, çka ndikoi edhe në ecurinë e fondeve të denominuara në euro. Fondi Raiffeisen Invest Euro arriti të rikuperojë pjesën më të madhe të humbjeve të shkaktuara përgjatë vitit 2020 për shkak të pandemisë, falë kujdesit të treguar në përzgjedhjen e obligacioneve me cilësi të lartë dhe zbatimit të një politike të kujdesshme investimesh. Por në pjesën e fundit të vitit, portofoli i investimeve të fondit Raiffeisen Invest Euro dhe portofoli i titujve të borxhit të fondit Raiffeisen Mix u ndikuan nga performanca e dobët e tregut të obligacioneve, për shkak se yield-et u rritën ndjeshëm në kushtet e presioneve të larta inflacioniste dhe shqetësimeve për vendimet agresive dhe reduktimin e stimujve monetare nga ana e Bankave Qendrore në të ardhmen e afërt. Fondet u fokusuan kryesisht në investime afatmesme, me qëllim uljen e riskut të normave të interesit.

Pavarësisht përshejtimit të mprehtë të inflacionit në fund të vitit 2021, Bankat Qendrore i mbajtën politikat e tyre monetare lehtësuese gjatë gjithë vitit. Ky fakt si edhe rimëkëmbja e shpejtë ekonomike e ndihmuan tregun e aksioneve të kishte një performancë pozitive vjetore dhe korporatat për pasojë të gjeneronin fitime të kënaqshme. Veçanërisht indekset amerikane shënuan performancën më të mirë duke kapur nivelet maksimale në fund të vitit 2021.

Për fondin Raiffeisen Mix, investimet në aksione kanë rezultuar shumë të favorshme dhe ky fond ka përfituar nga rritja e investimeve në këtë klasë asetesh. Fondi regjistroi një kthim vjetor neto shumë të kënaqshëm prej 4.68 përqind për vitin 2021.

Për sa i takon fondeve në monedhën Lekë, Prestigj dhe Vizion kanë ofruar një performancë vjetore mjaft të kënaqshme për investitorët dhe portofolet e investimeve të të dy fondeve kanë përfituar nga trendi rënës i normave të interesit të titujve të Qeverisë Shqiptare gjatë vitit 2021.

Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen ka vijuar të regjistrojë kthimin vjetor më të lartë gjatë vitit 2021 krahasuar me fondet e tjera të pensionit vullnetar që operojnë në tregun vendas.



# Fondi Raiffeisen Vizion

Fondi Raiffeisen Vizion është i denominuar në monedhën Lekë. Objektivi i Fondit është të maksimizojë kthimin total afatmesëm, duke synuar të ruajë kapitalin e investitorit dhe të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm.

Asetet e fondit janë të investuara kryesisht në bono thesari dhe obligacione thesari të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Horizonti i rekomanduar i qëndrimit në fond është të paktën 3 vjet, duke patur parasysh natyrën afatgjatë të investimeve të parashikuara në strategjinë e investimit të fondit dhe në mënyrë që të përmbushet objektivi i performancës së fondit.

Fondi Vizion aplikon një periudhë minimale qëndrimi në fond prej 2 vitesh. Çdo shlyerje përpara përmbushjes së periudhës 2-vjeçare, është subjekt i një tarife dalje prej 2 përqind e vlerës së kuotave të shlyera.

Gjatë vitit 2021 vlera neto e asetëve të fondit Vizion është rritur me 33.62 përqind duke arritur në 17.42 miliardë Lekë ose 144.3 milionë Euro në datën 31 Dhjetor 2021, ndërsa numri i anëtarëve në fond arriti 6,144.

## Politika e Investimit

Fondi synon të ketë një portofol investimesh të përqendruar kryesisht në tituj borxhi të emtuar ose garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Për të maksimizuar kthimin total nga investimi, Fondi synon të investojë të paktën 50 – 80 përqind të asetëve në obligacione afatgjatë të Qeverisë Shqiptare. Në 31 Dhjetor 2021, struktura e portofolit të investimeve paraqitet si në tabelën e mëposhtme :

Instrumenti	% e Aseteve
Bono Thesari	2.99
Obligacione Thesari	83.91
Depozita / Llogari rrjedhëse/ Të arkëtueshme	13.10

Investimet e Fondit Vizion janë kryer kryesisht në obligacione thesari afatgjatë. Në 31 Dhjetor 2021 fondi ka të investuara 19.5 përqind të asetëve në obligacione 7-10 vjet, 22.5 përqind të asetëve në obligacione me maturim 5 – 7 vjet , 31.3 përqind në obligacione me maturim 2 – 5 vjet, 13.7 përqind në obligacione deri në 2 vjet dhe bono thesari deri në 12-muaj. Likuiditeti i tepërt është investuar si depozitë afatshkurtër me bankat lokale.

Kohëzgjatja mesatare e portofolit të investimit (duration) është në nivelin 3.50 në datë 31 Dhjetor 2021.

## Performanca e Fondit

Në bazë vjetore, kthimi për vitin 2021 pasi zbritet tarifa e vazhdueshme është 4.43 përqind. Ndërsa kthimi për një periudhë 2 vjeçare ishte 3.06 përqind me bazë vjetore në datë 31 Dhjetor 2021.


Çmimi i kuotës ka ndjekur një trend rritës gjatë 2021, duke shënuar edhe rritjen e tij më të lartë me 1.21 përqind në muajin Mars.

Investimet e fondit Vizion impaktohen nga zhvillimet në tregun e brendshëm, siç janë ndryshimet në normat e interesit të titujve me maturitet kryesisht afatmesëm në afatgjatë të Qeverisë Shqiptare.

Në pjesën e parë të vitit normat e interesit patën një trend të lehtë rritës. Më pas në muajt Prill – Qershor ato u karakterizuan nga një trend rënës , për shkak të nivelit të lartë të likuiditetit. Këtë e dëshmoi edhe pjesëmarrja e lartë në ankandet e tregut primar të titujve ku raporti i pjesëmarrjes nëpër ankande ishte më i lartë se 1, megjithëse kërkesa e qeverisë për borxhin e brendshëm u rrit, sidomos për tituj afatgjatë. Tremujorin e tretë të vitit normat u stabilizuan duke vijuar më pas me rënie në muajt e fundit të vitit Nëntor dhe Dhjetor.

Fondi Vizion ka përfutur nga rënia e normave të interesit të obligacioneve gjatë vitit 2021 dhe vlera e investimeve është rritur. Të ardhurat nga interesat e obligacioneve të fondit kanë kontribuar gjithashtu pozitivisht në performancën e tij.

• Kthimi Vjetor në %



## Top 10 - Investimet Kryesore si përqindje e asetëve

### Fondi Raiffeisen Vizion

Instrumenti	% e Aseteve
Obligacion Thesari Referencë 5 vjet – Mat 30.01.2024	13.15%
Obligacion Thesari Referencë 5 vjet – Mat 26.03.2026	7.43%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 08.01.2030	7.06%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 10.09.2027	5.48%
Obligacion Thesari Referencë 5 vjet – Mat 19.07.2023	5.21%
Obligacion Thesari Referencë 5 vjet – Mat 26.03.2025	5.08%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 07.07.2031	4.99%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 12.03.2028	4.74%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 03.04.2028	4.66%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 06.07.2028	4.12%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 08.07.2029	3.62%

# Fondi Raiffeisen Prestigj

Fondi Raiffeisen Prestigj është i denominuar në monedhën lokale Lekë. Objektivi i fondit është të maksimizojë kthimin nga investimi, duke synuar njëkohësisht ruajtjen e kapitalit dhe sigurimin e likuiditetit të nevojshëm në shërbim të arritjes së objektivit.

Asetet e fondit janë të investuara kryesisht në bono thesari dhe obligacione thesari të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Vlera neto e aseteve të fondit arriti në 46.96 miliardë Lekë ose 389 milionë Euro në Dhjetor të 2021, duke shënuar një rritje prej 11.52 përqind në krahasim me vitin e mëparshëm. Numri i anëtarëve në fond ishte 29,301 në datën 31 Dhjetor 2021.

## Politika e Investimit


Gjatë vitit 2021, fondi Prestigj vijoi të kryejë investimet në tituj borxhi të Qeverisë Shqiptare, kryesisht me maturitet afatshkurtër deri në afatmesëm. Në 31 Dhjetor 2021, struktura e portofolit të investimeve paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Instrumenti	% e Aseteve
Bono Thesari	27.79
Obligacione Thesari	62.39
Depozita afatshkurtëra / Llogari rrjedhëse	7.26
Marrëveshje të Anasjellta të Riblerjes	2.56

Shpërndarja e aseteve të fondit kishte për qëllim prodhimin e një marzhi fitimi sa më të lartë, por në të njëjtën kohë edhe menaxhimin sa më efikas të riskut të likuiditetit dhe respektimin e raporteve të likuiditetit. Kohëzgjatja mesatare e portofolit të investimit (duration) është në nivelin 1.95 në datë 31 Dhjetor 2021. Likuiditeti i tepërt është investuar si depozitë afatshkurtër ose duke përdorur marrëveshjet e riblerjes me bankat lokale.

## Performanca e Fondit

Në bazë vjetore, kthimi për vitin 2021 pasi zbritet tarifa e vazhdueshme është 2.43 përqind, duke pësuar rritje në krahasim me vitin e shkuar.





Çmimi i kuotës ka ndjekur një trend rritës gjatë 2021, duke shënuar edhe rritjen e tij më të lartë me 0.58 përqind në muajin Mars.

Investimet e fondit Prestigj investimet e fondit impaktohen nga zhvillimet në tregun e brendshëm, siç janë ndryshimet në normat e interesit të titujve me maturitet kryesisht afatshkurtër ne afatmesëm të Qeverisë Shqiptare. Kështu trendi rënës i normave të interesit të këtyre titujve ndikoi pozitivisht në performancën e fondit gjatë vitit 2021.

## Top 10 – Investimet Kryesore si përqindje e asetëve

Fondi Raiffeisen Prestigj	
Instrumenti	% e Aseteve
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 29.10.2023	9.62%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 10.09.2027	6.86%
Obligacion Thesari referencë 5 vjet – Mat 26.03.2025	4.60%
Obligacion Thesari referencë 3 vjet – Mat 23.02.2024	3.48%
Obligacion Thesari referencë 5 vjet – Mat 26.03.2026	3.38%
Obligacion Thesari referencë 3 vjet – Mat 26.02.2023	3.36%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 13.03.2027	2.42%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 15.09.2028	2.37%
Bono Thesari 12 muaj – Mat 16.06.2022	2.34%
Bono Thesari 12 muaj – Mat 01.12.2022	2.32%

# Fondi Raiffeisen Invest Euro

Fondi Raiffeisen Invest Euro është i denominuar në monedhën Euro. Objektivi i fondit është t'i sigurojë investitorit një kthim konkurrues, në përputhje me një menaxhim të kujdesshëm të aseteve duke mbrojtur kapitalin dhe ruajtur nivelin e likuiditetit të nevojshëm.

Asetet e fondit janë të investuara kryesisht në obligacione të emetuara nga Qeveria Shqiptare në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar, në obligacione të emetuara nga qeveri të vendeve të BE-së dhe korporata ndërkombëtare, në depozita bankare afatshkurtëra dhe në fonde investimi, të cilat gjithashtu kanë në fokus investime në tregun e obligacioneve.

Vlera neto e aseteve të fondit është 67.12 milionë Euro në 31 Dhjetor 2021, duke shënuar një rënie me 3.73 milionë Euro ose 5.26 përqind në krahasim me vitin e shkuar. Numri i anëtarëve në fond në fund të 2021 është 2,863.

## Politika e Investimit

Gjatë vitit 2021 është zbatuar një politikë investimi efikase për të përfituar nga luhatja e vazhdueshme e normave të interesit në tregjet financiare të zonës euro dhe duke u kujdesur për manaxhimin e risqeve të tregut me një shpërndarje efektive të aseteve.

Në tërësi shpërndarja e aseteve të fondit kishte për qëllim diversifikimin e portofolit, me qëllim reduktimin e riskut të tregut, riskut të kreditit, dhe sigurimin e likuiditetit të nevojshëm. Strategjia e investimeve ka qenë e fokusuar kryesisht në ruajtjen e niveleve mesatare të kohëzgjatjes (duration) të portofolit të investimit me qëllim ofrimin e një normë kthimi të kënaqshme, duke u mbrojtur në të njëjtën kohë nga rritja e normave të interesit. Niveli i kohëzgjatjes mesatare ka ardhur duke u ulur gjatë vitit në përshtatje me rrethanat e krijuara dhe trendin e normave të interesit. Kështu, nga 4.05 në fund të Dhjetorit 2020, ai ka arritur nivelin 3.53 në fund të Dhjetorit 2021.


Në 31 Dhjetor 2021 struktura e Portofolit të investimeve paraqitet si në tabelën e mëposhtme :

Instrumenti	% e Aseteve
Obligacione të Qeverisë Shqiptare	38.28
Obligacione të Qeverive të huaja	2.32
Obligacione të Korporatave	28.15
Fonde të investimeve	28.38
Depozita / Llogari rrjedhëse	2.87

## Performanca e Fondit

Viti 2021 ishte një vit me luhatshmëri të mëdha për tregun e obligacioneve të denominuara në euro, gjë që u reflektua edhe te çmimi i kuotës së fondit Euro. Fondi e nisi vitin me një çmim kuote prej 117.9211, një rikuperim i kënaqshëm nga niveli më i ulët i pandemisë. Por, vonesat me procesin e vaksinimit, zgjatja e masave izoluese dhe pritshmëritë për një tërheqje të stimulit të Bankave Qendrore, vazhduan të shkaktonin frikë dhe pasiguri, të cilat u reflektuan edhe në tregjet ndërkombëtare të obligacioneve. Për shkak të rritjes së normave të interesit, portofoli i investimeve performoi negativisht dhe pati një rënie të lehtë të çmimit të kuotës përgjatë muajve Janar-Maj. Në vazhdim, tregjet financiare u ndihmuan nga disa katalizatorë të dobishëm: politika e vazhdueshme e normave të ulëta të interesit nga Bankat Qendrore, çmimi i moderuar i naftës dhe rritja në shpenzimet konsumatore si pasojë e optimizmit për përfundimin e pandemisë dhe fitimeve të larta të korporatave. Ky rikuperim u ndje edhe në fondin Euro ku çmimi i kuotës iu rikthye trendit rritës gjatë muajve të verës.

Që nga fillimi i pandemisë Bankat Qendrore luajtën një rol aktiv në luftimin e pasojave ekonomike me injektimin e likuiditetit, programin e blerjes së obligacioneve dhe nxitjen për kredihënien e bankave ndaj sektorit privat. Por, presionet inflacioniste të muajve të fundit të vitit sinjalizuan se inflacioni nuk mund të trajtohej më si një problematikë kalimtare, duke i detyruar Bankat Qendrore të ndryshonin qëndrim. Si Banka Qendrore Amerikane, ashtu dhe Banka Qendrore Europiane lajmëruan reduktim në programin e blerjes së obligacioneve. Banka Qendrore Amerikane gjithashtu përcaktoi një seri rritjesh të normave të interesit gjatë viteve të ardhshme. Të gjitha këto ndikuan negativisht në performancën e tregut të obligacioneve dhe, rrjedhimisht edhe në performancën e fondit Invest Euro, i cili e mbylli vitin me një kthim neto vjetor prej -1.00%.



## Top 10 – Investimet Kryesore si përqindje e asetëve

### Fondi Raiffeisen Invest Euro

Instrumenti	% e Aseteve
Eurobond 7 vjet i Qeverisë Shqiptare – Maturim Tetor 2025	26.26%
Eurobond 7 vjet i Qeverisë Shqiptare – Maturim Qershor 2027	12.02%
Fond Investimi – Raiffeisen Euro Rendite	6.01%
Fond Investimi – Raiffeisen 304 Euro Corporates	4.54%
Fond Investimi – Alliance Bernstein European Income	3.33%
Obligacion i Raiffeisen Bank International – Maturim Qershor 2032	3.16%
Obligacion i Raiffeisen Bank International – Maturim Mars 2030	3.04%
Fond Investimi – Raiffeisen Nachhaltigkeit Rent	3.03%
Fond Investimi – AB SICAV I Short Duration High Yield	2.94%
Fond Investimi – Morgan Stanley European High Yield Bond	2.94%



**Raiffeisen**  
**INVEST**

# RAIFFEISEN MIKS

Jepi larmi investimit tënd

---

## PORTOFOL MIKS

mundëson një balancë  
midis riskut dhe përfitimit

---

## DIVERSIFIKIM I INVESTIMEVE

për fondet  
në monedhë të huaj

---

## TREGJE NDËRKOMBËTARE

Pjesëmarrje në tregjet e  
huaja të aksioneve/  
obligacioneve

[www.raiffeisen-invest.al](http://www.raiffeisen-invest.al)

# Fondi Raiffeisen Miks

Fondi Raiffeisen Miks është i denominuar në monedhën Euro. Objektivi i investimit të Fondit është krijimi i të ardhurave të rregullta dhe një rritje e moderuar e kapitalit në një periudhë afatmesme.

Asetet e fondit investohen në instrumente financiare që i përkasin tre kategorive kryesore të aseteve: Tituj borxhi, Aksione, Tregu i parasë dhe ekuivalentë cash-i.

Vlera neto e aseteve të fondit është 4.42 milionë Euro në 31 Dhjetor 2021. Numri i anëtarëve në fond në fund të 2021 është 137.

## Politika e Investimit

Në mënyrë që të arrihet qëllimi i investimit, fondi investon deri në 75% të totalit të aseteve në Tituj borxhi, të cilat emetohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, një vend i BE-së apo çdo shtet tjetër i miratuar nga rregullatori vendas, nga institucionet ndërkombëtare dhe / ose shoqëri tregtare. Për më tepër, për të maksimizuar kthimin total nga investimi, fondi mund të investojë deri në 40% të aseteve në aksione, kryesisht të tregtuar në tregjet e zhvilluara në SH.B.A. dhe Europë.

Portofoli i fondit Miks është ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga investimi dhe diversifikimi nga të dyja kategoritë e aseteve siç janë obligacionet dhe aksionet. Politika e investimit është ende në procesin e implementimit. Niveli i kohëzgjatjes mesatare të portofolit të investimit për titujt e borxhit (duration) është 3.32 në fund të Dhjetor 2021.

Në 31 Dhjetor 2021 struktura e Portofolit të investimeve paraqitet si në tabelën e mëposhtme :

Instrumenti	% e Aseteve
Obligacione	44.39
Aksione	38.43
Fonde të investimeve	9.08
Depozita / Llogari rrjedhëse	8.09

## Performanca e Fondit

Në bazë vjetore, kthimi për vitin 2021, pasi zbritet tarifa e vazhdueshme, është 4.68 përqind.

Viti 2021 ishte një vit me luhatshmëri të mëdha për tregun e obligacioneve të denominuara në euro, por në të njëjtën kohë ishte një vit me tejet pozitiv për tregun e aksioneve, të cilat arritën nivele rekord. Fondi e nisi vitin me një çmim kuote prej 100.0123, një rritje e lehtë nga momenti i lançimit. Por, për shkak të rritjes së normave të interesit dhe rënies së çmimeve të aksioneve, portofoli i investimeve performoi negativisht dhe pati një rënie të çmimit të kuotës përgjatë muajve Janar-Shkurt. Gjithsesi, në vazhdim, tregjet e kapitalit gjeneruan fitime të mëtejshme, sepse rimëkëmbja ekonomike solli një rritje të theksuar të fitimeve të korporatave. Rikuperimi u ndje dukshëm në fondin Miks ku çmimi i kuotës ndoqi një trend rritës që nga muaji Mars e deri në fund të verës.

Pavarësisht performancës negative të tregut të obligacioneve, aksionet e mbyllën vitin në nivele rekord, duke e bërë të papërfillshëm impaktin negativ të obligacioneve në portofolin e investimeve të fondit Miks.

## Top 10 - Investimet Kryesore si përqindje e aseteve

Fondi Raiffeisen Miks	
Instrumenti	% e Aseteve
Eurobond 7 vjet i Qeverisë Shqiptare – Maturim Qershor 2027	15.03%
Eurobond 7 vjet i Qeverisë Shqiptare – Maturim Tetor 2025	12.1%
Fond Investimi – Vanguard S&P 500	7.45%
Fond Investimi – ISHARES STOXX EUROPE 600	7.05%
Fond Investimi – Raiffeisen Sustainable Equity	6.99%
Fond Investimi – Raiffeisen Europa High Yield	4.52%
Obligacion i EP Infrastructure – Maturim Korrik 2026	3.54%
Fond Investimi – Raiffeisen US Aktien	3.22%
Fond Investimi – Raiffeisen Sustainable Europe Equity	2.99%
Fond Investimi – Vanguard Developed World	2.76%

# Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen

Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen është i denominuar në monedhën Lek dhe është një mënyrë alternative kursimi, e përdorur ekskluzivisht për kursime afatgjata.

Objektivi i fondit është investimi i aseteve sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për pension dhe riskut të marrë përsipër.

Vlera neto e aseteve të fondit arriti në Lekë 1.04 miliardë ose 8.6 milionë Euro në 31 Dhjetor 2021 duke u rritur me 18 përqind në krahasim me vitin e shkuar. Numri i anëtarëve në fond në fund të 2021 shënoi rritje prej 3.3 përqind krahasuar me vitin paraardhës ose 102 anëtarë më shumë.

## Politika e Investimit

Fondi i Pensionit vijoi investimet në obligacione afatgjatë me maturitet 5, 7 dhe 10 vjeçar, të emetuara nga Qeveria shqiptare në tregun vendas. Shpërndarja e aseteve të fondit kishte për qëllim prodhimin e një marzhi fitimi sa më të lartë, objektiv i cili u arrit me sukses, megjithëse mjedisi financiar është dominuar nga norma interesi të ulëta. Në 31 Dhjetor 2021 struktura e Portofolit të investimeve paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Instrumenti	% e Aseteve
Obligacione Thesari	97.46
Depozita / Llogari rrjedhëse	2.54


## Performanca e Fondit

Në bazë vjetore, kthimi për vitin 2021 është 4.44 përqind, duke pësuar rritje në krahasim me vitin e mëparshëm, si dhe duke shënuar kthimin neto vjetor më të lartë në treg gjatë vitit 2021.

Në tërësi çmimi i kuotës së Fondit të Pensionit ka ndjekur një trend rritës përgjatë vitit.

Asetet e Fondit janë të investuara vetëm në tituj të emtuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe për këtë arsye fondi është i ekspozuar ndaj ndryshimeve në normat e tyre të interesit. Gjatë gjithë vitit 2021 rritja e çmimit të kuotës së fondit ka qenë e qëndrueshme duke shënuar edhe rritjen e tij më të lartë me 0.46 përqind në muajin Shkurt. Fondi pati një rritje më të ulët në Tetor me 0.32 përqind dhe kjo i atribuohet rritjes së normave të interesit të titujve afatgjatë të emtuar nga Qeveria Shqiptare.

• Kthimi Vjetor në %



Kthimi mesatar vjetor neto që nga momenti i lançimit të fondit deri në 31 Dhjetor 2021 është 6.36 përqind. Në datën 31 Dhjetor 2021, performanca e fondit është 5 përqind (me bazë vjetore) për një periudhë 5 vjeçare dhe 4.39 përqind (me bazë vjetore) për një periudhë 2 vjeçare.

## Top 10 - Investimet Kryesore si përqindje e aseteve

<b>Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen</b>	
<b>Instrumenti</b>	<b>% e Aseteve</b>
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 08.07.2029	8.29%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 07.07.2031	7.11%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 15.01.2031	7.06%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 28.07.2030	6.1%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 08.01.2030	5.82%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 16.01.2029	4.99%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 06.07.2028	4.36%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 18.01.2026	4.32%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 23.01.2025	3.41%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 13.03.2026	2.36%



# JAZZ IN ALBANIA



10<sup>th</sup>  
Edition

16 -19 September  
& 16 October  
Place: Mayfair Bar Time: 20.00



Tricia Evy Duo  
FRANCE



Duo Yarkin  
TURKEY

Organized by:



SYRI BLU



Thomas  
Hufschmidt Trio  
GERMANY



Kuhinjazz  
MONTENEGRO



Stoned Heads  
SERBIA



Sokrates Votskos  
Quartet  
GREECE



Sanna  
Ruohoniemi  
SWEDEN



Ziv Eitan  
ISRAEL



AJS Quartet  
ALBANIA



Next to silence  
NORTH MACEDONIA



V4 Quartet



Supported by:





# Raport i Menaxherit të Riskut

## Tregues të Riskut në 31 Dhjetor 2021

Fondi	Kohëzgjatja	Kohëzgjatja e modifikuar	Devijimi standard	*Treguesi sintetik i Riskut
Raiffeisen Prestigj	1.95	1.92	1.47%	Niveli 2
Raiffeisen Vizion	3.50	3.43	1.72%	Niveli 3
Raiffeisen Invest Euro	3.53	3.48	3.04%	Niveli 3
Raiffeisen Mix **	3.32	3.26	Na	Niveli 4
Raiffeisen Pension	4.52	4.40	0.45%	Niveli 1

\* Treguesi i riskut sintetik dhe përfitimit jep informacion mbi nivelin e riskut të fondit (nga niveli 1 deri në nivelin 7) duke u bazuar mbi luhatshmërinë historike të performancës së fondit.

\*\*Për fondin Raiffeisen Mix, kohëzgjatja mesatare dhe kohëzgjatja e modifikuar raportohen duke përjashtuar pjesën e investuar në aksione.

Administrimi i Riskut kryhet nga një njësi e pavarur e cila mat, monitoron, dhe raporton në Këshillin e Administrimit, Komitetin e Investimit dhe AMF respektimin e limiteve dhe treguesit e ndryshëm të riskut. Gjatë vitit 2021, janë respektuar të gjitha limitet ligjore apo ato të përcaktuara në prospektet e fondeve si dhe janë kryer në mënyrë të rregullt provat e rezistencës për likuiditetin të cilat janë kaluar me sukses nga të gjitha fondet.

Për fondet në lekë, Raiffeisen Prestigj, Vizion dhe Pension, treguesit kanë qenë stabilë dhe luhatshmëria e tyre ka qenë e ulët, pasi normat e interesit në tregun vendas nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha. Fondet në euro, Fondi Raiffeisen Invest Euro dhe Fondi Miks kanë pasur një luhatshmëri më të lartë për shkak sfidave me të cilat tregjet ndërkombëtare janë përballur si: rritja e inflacionit shoqëruar me rritje të normave të interesit, ndërprerjet në zinxhirët e furnizimit dhe pasigurive lidhur me variantet e reja të Covid.

Për fondin Prestigj, gjatë vitit 2021, kohëzgjatja mesatare të portofolit të investimit ka qendruar stabilë. Luhatshmëria e ulët normave të titujve të qeverisë shqiptare ka bërë që treguesit e riskut si devijimi standard ose luhatshmëria e kthimit të jenë stabilë. Treguesi sintetik i riskut mbetet i pandryshuar në nivelin 2. Kjo tregon që fondin Prestigj vazhdon të jetë një fond me profil të ulët risku.

Fondi Vizion gjithashtu ka patur një luhatshmëri të lehtë, por duke qenë një fond me investime më afatgjatë, treguesi sintetik i riskut është vlerësuar në nivelin 3, bazuar mbi historikun e të dhënave dhe luhatshmërisë së normave të titujve të qeverisë shqiptare.

Për fondin Raiffeisen Invest Euro, kohëzgjatja mesatare e portofolit është ulur në mënyrë të moderuar për të zbutur efektet e rivlerësimit negativ nga rritja e normave të interesit. Megjithatë, edhe pse efektet e luhatshmërisë së rritur në tregjet ndërkombëtare janë shoqëruar me një rritje të luhatshmërisë së kthimeve të fondit Invest Euro, treguesi i riskut sintetik ka qendruar stabilë në nivelin 3, çka tregon për një fond me profil risku mesatar.

Për fondin e Pensioneve Vullnetare, duke qenë se pjesa më e madhe e portofolit do të mbahet deri në maturim dhe vlerësohet me amortizim linear, luhatshmëria e kthimit është tepër e ulët. Si rezultat, treguesi sintetik i riskut është në nivelin 1.

Fondi Miks u lançua në Nëntor 2020 dhe është ende shumë herët për të matur devijimin standard të tij apo luhatshmërinë e kthimeve. Megjithatë, bazuar mbi historikun e luhatshmërisë së tregjeve ndërkombëtare dhe politikën e investimit që zbatohet për këtë fond, treguesi i riskut sintetik dhe përfitueshmërisë vlerësohet në nivelin 4.



# Pasqyrat Financiare & Raporti i Audituesit të Pavarur

---

# Përmbajtje

**RAIFFEISEN INVEST – SHOQËRI ADMINISTRUESE E  
FONDEVE TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJEVE TË  
INVESTIMEVE KOLEKTIVE SH.A.**

**Pasqyrat financiare  
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**  
(me raportin e Audituesit të pavarur)

---

<b>Raporti i Audituesit të Pavarur</b>	38
<b>Pasqyrat Financiare</b>	
Pasqyra e Pozicionit Financiar	40
Pasqyra e Fitim ose Humbjes dhe të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	40
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	41
Pasqyra e Flukseve të Parasë	42
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare	43

# Raporti i Audituesit të Pavarur

**Për aksionarët e "Raiffeisen Invest" sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

## *Opinionit*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Raiffesien Invest (këtu e më poshtë i referuar si, "Shoqëria") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021 si edhe të performancës së saj financiare dhe parave për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

## *Bazat e Opinionit*

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (kodi "BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me kodin BKSNE.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

## *Çështje të tjera*

Pasqyrat financiare të veçanta të bankës më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, u audituan nga një tjetër auditues i cili shprehu një opinion të pamodifikuar mbi këto pasqyra financiare më 25 maj 2021

## *Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e tij në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveç se sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontroleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontroleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi.

Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

*Deloitte Audit Albania shpk.*

### Deloitte Audit Albania shpk

Rruga e Kavajës, ish parku i mallrave, Kompleksi Delijorgji, Godina L

Tirana, Albania

Numër unik identifikimi i subjektit (NUIS): L41709002H



Audituesi ligjor  
Partner Angazhimi  
Enida Cara

Tiranë, Shqipëri  
27 maj 2022

**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR MË 31 DHJETOR 2021**

(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
<b>AKTIVET</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	8	580,507,569	669,099,677
Llogari të arkëtueshme nga Fondet	9	74,929,471	75,051,095
Aktive financiare të matura me kosto të amortizuar	10	22,226,722	16,147,504
Parapagime ndaj punonjësve	-	637,570	1,773,169
Aktive materiale	11	37,209,472	8,072,060
Aktive jomateriale	12	10,656,658	4,592,124
Tatim fitimi i parapaguar	19	-	2,065,550
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>726,167,462</b>	<b>776,801,180</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Tatim fitimi i pagueshëm		6,853,446	-
Detyrime të tjera	13	27,648,051	21,414,831
Detyrime qiraje	14	27,224,272	-
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>61,725,769</b>	<b>21,414,831</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali aksioner	15	90,000,000	90,000,000
Rezerva logjore	15	9,000,000	9,000,000
Fitim/(Humbje) të mbartura		565,441,693	656,386,349
<b>TOTALI I KAPITALIT</b>		<b>664,441,693</b>	<b>755,386,349</b>
<b>TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE</b>		<b>726,167,462</b>	<b>776,801,180</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 44 deri në 69, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Këshilli i Administrimit të Raiffesien INVEST- Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. më 27 maj 2022.



**Administratore e Përgjithshme**  
Znj. Edlira KONINI

**Zv. Administratore e Përgjithshme**  
Znj. Alketa EMINI



## Pasqyra e të ardhurave Gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
<b>Të ardhurat</b>			
Tarifa të administrimit të Fondeve	15	878,701,850	825,860,624
Të ardhura interesi	16	1,069,162	1,149,399
Tarifa të largimit nga fondi	9	1,612,930	2,024,108
Të ardhura të tjera		34,000	48,000
		<b>881,417,943</b>	<b>829,082,130</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzime për personelin	17	(49,812,084)	(51,211,553)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	11,12	(5,879,274)	(7,408,062)
Shpenzime të tjera	18	(590,051,496)	(527,307,388)
		<b>(645,742,853)</b>	<b>(599,314,602)</b>
Humbje nga kursi i këmbimit		(222,336)	(958,411)
		<b>(222,336)</b>	<b>(958,411)</b>
<b>Fitimi neto para tatimit</b>		<b>235,452,754</b>	<b>242,196,716</b>
Tatim fitimi	19	(104,852,410)	(97,672,130)
<b>Fitimi neto pas tatimit</b>		<b>130,600,344</b>	<b>144,524,586</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>130,600,344</b>	<b>144,524,586</b>

Pasqyra e fitimit ose e humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 44 deri në 69, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Fitim(Humbje) të mbartura	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2020</b>	<b>90,000,000</b>	<b>9,000,000</b>	<b>511,861,763</b>	<b>610,861,763</b>
Fitimi i vitit	-	-	144,524,586	<b>144,524,586</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse				
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>144,524,586</b>	<b>144,524,586</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>90,000,000</b>	<b>9,000,000</b>	<b>656,386,349</b>	<b>755,386,349</b>
Fitimi i vitit	-	-	130,600,344	<b>130,600,344</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>130,600,344</b>	<b>130,600,344</b>
Pagesa e dividendit			(221,545,000)	<b>(221,545,000)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>90,000,000</b>	<b>9,000,000</b>	<b>565,441,693</b>	<b>664,441,693</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 44 deri në 69, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
<b>Fluksi I parave nga aktiviteti operativ</b>			
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>130,600,344</b>	<b>242,196,716</b>
<b>Rregulluar me:</b>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	11,12	5,879,274	7,408,062
Të ardhura nga interesi		(1,069,162)	(1,149,399)
Shpenzimi i interesit	14	185,228	-
		<b>240,448,094</b>	<b>248,455,379</b>
<b>Ndryshime në:</b>			
Të arkëtueshme nga fondet	9	121,625	(3,230,389)
Aktive të tjera		1,135,598	(991,479)
Detyrime të tjera	13	6,233,220	(1,290,891)
<b>Paratë nga aktiviteti operativ</b>		<b>247,938,537</b>	<b>242,942,620</b>
Interesi i arkëtuar		989,944	1,236,556
Tatim fitimi i paguar		(95,933,412)	(94,118,692)
<b>Paratë neto të gjeneruara nga aktiviteti operativ</b>		<b>152,995,069</b>	<b>150,060,484</b>
<b>Paratë nga aktiviteti investues</b>			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	11	(4,233,424)	(1,884,469)
Blerja e aktiveve afatgjata jomateriale	12	(8,295,734)	(535,773)
Blerje e aktiveve financiare të mbajtura deri në maturim	10	(22,000,000)	-
Shitje / Maturim i aktiveve financiare të maturuara të mbajtura deri në maturim	10	16,000,000	5,000,000
<b>Para neto nga aktiviteti investues</b>		<b>(18,529,158)</b>	<b>2,579,759</b>
<b>Paratë nga aktiviteti financues</b>			
Dividenti i paguar		(221,545,000)	-
Pagesa për detyrimet e qirasë		(1,513,019)	-
<b>Paratë neto të përdorura në aktivitetin investues</b>		<b>(223,058,019)</b>	<b>-</b>
Pakësimi/Rritje neto të parave dhe ekuivalentë të tyre gjatë vitit		(88,592,108)	144,212,319
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 janar</b>	<b>8</b>	<b>669,099,677</b>	<b>516,459,434</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor (Shënimi 6)</b>	<b>8</b>	<b>580,507,569</b>	<b>669,099,677</b>

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 44 deri në 69, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# 1. HYRJE

Raiffeisen INVEST- Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive" sh.a. ("Shoqëria") është një shoqëri aksionere shqiptare me qendër në Tiranë. Shoqëria është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë nga Gjykata e Tiranës me vendimin nr. 33825, i dates 18 korrik 2005. Zyrat qendrore ndodhen në Rrugën Tish Dija, Kompleksi Kika 2, kati i dytë, Tiranë.

Shoqëria është licencuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare ("AMF") më 7 korrik 2005 (Licencë Nr. 2) për të vepruar si shoqëri administruese e Fondeve të Pensionit Vullnetar në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit. Gjithashtu, Shoqëria është licencuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 13 Dhjetor 2011 (Licencë Nr. 1) për të vepruar si shoqëri administruese e asetëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Aktiviteti i Shoqërisë mbikqyret nga AMF, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9572, datë 03 korrik 2006 "Për Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare", ligjit nr.10197, datë 10 Dhjetor 2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" dhe ligjit nr.10198, datë 10 Dhjetor 2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Shoqëria ka një marrëveshje për shërbime depozituese për fondin e pensioneve me Bankën e Parë të Investimeve të Shqipërisë, me seli në Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kulla Binjake 2, Kati 14, Tirana ("Banka Kujdestare").

Banka Kujdestare është e licencuar nga Banka e Shqipërisë për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit (vendimi nr.13, datë 10.03.2010). Banka Kujdestare është gjithashtu e licencuar nga AMF për të ofruar shërbime depozitimi për asetet e fondit të pensionit (vendimi nr. 80, datë 30 gusht 2010) dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive (vendimi nr.1, datë 13.12.2011).

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është:

- menaxhimi i fondit të pensionit vullnetar nëpërmjet mbledhjes dhe investimit të fondeve bazuar në Ligjin nr. 10197, të datës 10 Dhjetor 2009 "Mbi fondet e pensionit vullnetar", si dhe në përputhje me parimin e shperndarjes së rrezikut (diversifikimit), si qëllim për të siguruar përfitime pensioni për personat që janë anëtarë të fondit. Shoqëria mund të sigurojë gjithashtu kryerjen e pagesave të pensionit;
- të themeloje dhe/ose të menaxhojë Sipërmarrje të Investimeve Kolektive bazuar në Ligjin nr. 10198, të dates 10 Dhjetor 2009 "Mbi sipërmarrjet e investimeve kolektive";
- të përformoje aktivitete të tjera siç përshkruhet në Ligjin nr. 10198, të dates 10 Dhjetor 2009 "Mbi sipërmarrje të investimeve kolektive".

Shoqëria vepron si Shoqëri Administruese për fondet e mëposhtme:

- Fondi me Kontribute të Përcaktuara "Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen" i aprovuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 18 tetor 2010;
- "Raiffeisen Prestigj"- fond investimi i cili u aprovua nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 13 Dhjetor 2011;
- "Raiffeisen Vision"- fond investimi i cili u aprovua nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 30 korrik 2018
- "Raiffeisen Invest Euro"- fond investimi i cili u aprovua nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 26 shtator 2012.
- "Raiffeisen Mix"-fond investimi i cili u aprovua nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 23 tetor 2020.

Këshilli i Administrimit si organi qendror i Shoqërisë përbëhet nga 8 anëtarë si më poshtë:

Znj. Donalda GJORGA	Kryetare
Z. Peter ZILINEK	Nën Kryetar
Znj. Vilma BAÇE	Anëtare
Znj. Alda SHEHU	Anëtare
Z. Joan CANAJ	Anëtar
Znj. Edlira KONINI	Anëtare
Znj. Alketa EMINI	Anëtare

Administratorët janë:

Znj. Edlira KONINI	Administratore e Përgjithshme
Znj Alketa EMINI	Zv/Administratore e Përgjithshme

## 2. BAZA E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 janë aprovuar nga grupi i menaxhimit të Shoqërisë më 25 maj 2022.

### 2.1 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë, i cili supozon që Shoqëria do të vazhdojë veprimtarinë e saj operacionale për të paktën një periudhë prej 12 muajsh nga data e raportimit financiar. Shoqëria kryen provat e rezistencës për cdo fond të administruar prej saj, me qëllim përlllogaritjen e likuiditetit të nevojshëm në kushtet e skenarëve të përkeqësuar të tregut, nën supozimin e tërheqjes së kuotave nga 3 në 30 ditë dhe kohës së nevojshme për likuidimin e investimeve të cdo fondi.

Shoqëria vazhdon të ruajë një nivel të kënaqshëm likuiditeti si rezultat i rritjes së vlerës neto të aktiveve të fondeve Raiffeisen Pension dhe Raiffeisen Vision. Sipas provave të rezistencës, vlerësohet se fondet mund të arrijnë të përballojnë skenarët e përkeqësuar, duke qënë në përputhje me kërkesat rregullatore për likuidimet brenda afatit ligjor.

Bazuar në sa më lart dhe në rezultatet e provave të rezistencës, Drejtimi i Shoqërisë ka arritur në përfundim se nuk ka pasiguri të qenësishme në aftësinë e Shoqërisë për të vijuar aktivitetin e saj, për të ardhmen e parashikueshme, prej të paktën 12 muajsh nga data e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare. Si rrjedhojë, Drejtimi gjykon se parimi i vijimësisë është bazë e përshtatshme në përgatitjen e këtyre pasqyrave.

## 3. MONEDHA FUNKSIONALE DHE RAPORTUESE

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale për Shoqërinë.

## 4. BAZAT E MATJEVE

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

## 5. VLERËSIME DHE GJYKIME KONTABËL

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi i Shoqërisë të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga çmuarjet.

Çmuarjet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve njihen në mënyrë prospektive.

### A. Gjykime

Informacioni për gjykimet e bëra në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektet më të rëndësishme në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë të përfshira në shënimin e mëposhtëm:

- Shënimi 6(b) – njohja e të ardhurave: nëse të ardhurat janë njohur përgjatë kohës ose në një pikë në kohë

### B. Supozimet dhe vlerësimet e pasigurive

Informacioni mbi vlerësimin e pasigurive të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve të paraqitura në pasqyrat financiare përshkruhet në paragrafët në vijim:

- Shënimi 21(i) – zhvlerësimi i instrumenteve financiare: përcaktimi i të dhënave për modelin e matjes të HPK-ve, përfshirë informacionin mbi të ardhmen;
- Shënimi 22: njohja dhe matja e detyrimeve të kushtëzuara: vlerësimet kryesore për mundësinë dhe sasinë e flukseve dalëse të burimeve.

Më 11 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli situatën e pandemisë për shkak të emergjencës globale të shkaktuar nga COVID 19. Në përgjigje të pandemisë, qeveria shqiptare implementoi një sërë masash për të kufizuar përhapjen dhe ndikimin e COVID-19, si ndalimi/ kufizimi i udhëtimeve, karantinimi i personave të infektuar, si dhe vendosi kufizime mbi aktivitetin e bizneseve, deri në mbylljen e këtyre të fundit. Masat e mësipërme u lehtësuan gradualisht përgjatë 2020 dhe 2021. Këto masa, përveç të tjerash, kanë limituar aktivitetin ekonomik në Shqipëri duke e ndikuar negativisht. Impakti negativ mbi bizneset dhe pjesëtarët e tregut, në Shqipëri dhe më gjerë, mund të vazhdojë për një periudhë të panjohur kohore.

Që prej fillimit të 2020, pandemia e shkaktuar prej koronavirusit të ri ka ndikuar ekonominë globale. Në fazat e para të përhapjes, Shoqëria ka marrë masa në kohën e duhur, për të siguruar shëndetin e punonjësve të saj dhe njëkohësisht për të ruajtur nivelin e produktivitetit dhe vijimësinë e shërbimit ndaj klientit në kohë dhe pa vonesa. Pandemia Covid-19 nuk ka ndikim në Shoqëri dhe Drejtimi beson se nuk do të ketë ndonjë ndikim në aftësinë e shoqërisë për të aplikuar parimin e vijimësisë.

## 6. NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja, si dhe ndryshime të standardeve ekzistuese, që ende nuk janë efektive dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria, janë publikuar nga BSNK. Informacion mbi ato standarde që pritet të jenë të rëndësishme për pasqyrat financiare të Shoqërisë është dhënë më poshtë. Standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet, të cilat nuk janë miratuar apo të shënuara më poshtë nuk pritet të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

### Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën aktuale

Standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, janë efektive për periudhën aktuale:

- Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiarë", SNK 39 "Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja", SNRF 7 "Instrumentet Financiarë: Shënimet Shpjeguese", SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit" dhe SNRF 16 "Qiratë"- Reforma e Normës së Interesit Bazë – Faza 2 (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2021),
- Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë" - Koncesionet e Qirasë të lidhura me Covid-19 (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 qershor 2020. Lejohet zbatimi më i hershëm).
- Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit" – Zgjatja e Përrjashtimit të Përkohshëm nga Zbatimi i SNRF 9 (data e skadencës për përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 u zgjat në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2023).
- Ndikimi i aplikimit fillestar të Koncesioneve të Qirasë lidhur me COVID-19 përtej 30 Qershorit 2021—Amendimi i SNRF 16

Këto ndryshime nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në Pasqyrat Financiare dhe për këtë arsye nuk janë bërë shënime shpjeguese.

### Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja, rishikimet e standardeve ekzistuese dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma nuk ishin në fuqi:

- SNRF 17 Kontratat e sigurimit- Efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023).
- Ndryshimet në SNRF 16 Qiratë - Koncesionet e Qirasë të Lidhura me Covid-19 përtej 30 Qershorit 2021 (efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 Prill 2021. Zbatimi më i hershëm lejohet, duke përfshirë në pasqyrat financiare të paautorizuara ende për lëshim në datën amendamenti lëshohet.)
- Ndryshimet në SNRF 10 Konsolidimi i Pasqyrave Financiare dhe SNK 28 Investimet në Kompanitë dhe Ndërmarrjet e Përbashkëta - Shitja ose Kontributi i Aseteve ndërmjet një investitori dhe ndërmarrjes së përbashkët ose ndërmarrjeve dhe ndryshimet pasuese - Data efektive është ende e papërcaktuar;

## 6.1. Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën aktuale

### 6.1.1. Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria

- Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare - Klasifikimi i pasiveve si afatshkurtër ose afatgjatë - Në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023.
- Ndryshime në SNRF 3 Kombinim Biznesi - Referencë e Kuadrit Konceptual me përmirësime të SNRF 3 - Data e hyrjes në fuqi fillon më 1 janar ose pas datës 1 janar 2022, duke lejuar aplikim të hershëm;
- Ndryshimet në SNK 16 Prona të paluajtshme, pajisjet dhe makineri - Të ardhurat para përdorimit të synuar - Data e hyrjes në fuqi fillon më 1 janar ose pas datës 1 janar 2022, duke lejuar aplikim të hershëm;
- Ndryshimet në SNK 37 Provigjione, detyrime të kushtëzuara dhe aktive të kushtëzuara - Kontrata në vazhdim - Kostoja e kryerjes së një kontrate - Data e hyrjes në fuqi fillon më 1 janar ose pas datës 1 janar 2022, duke lejuar aplikim të hershëm;
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve SNRF 2018-2020—Ndryshime në SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, SNRF 9 Instrumentet Financiare, SNRF 16 Qiratë dhe SNK 41 Bujqësia - Data e hyrjes në fuqi fillon më 1 janar ose pas datës 1 janar 2022, duke lejuar aplikim të hershëm;
- Ndryshimet në SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet—Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023 për ndryshimet në politikat kontabël dhe ndryshimet në vlerësimet kontabël që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe, me aplikim të më të hershëm të lejueshëm.
- Ndryshimet në SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat - Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm - Efektive për periudhat e raportimit vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023, duke lejuar aplikim të hershëm;
- Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë" - Koncesionet e Qirasë të Lidhura me Covid-19 përtej 30 Qershorit 2021 (efektive për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 Prill 2021. Zbatimi më i hershëm lejohet, duke përfshirë në pasqyrat financiare të paautorizuara ende për lëshim në datën në të cilën është lëshuar amendamenti.)
- Drejtimi parashikon që të gjitha njoftimet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë që fillon në ose pas datës efektive të publikimit.

## 7. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Efekti i zbatimit fillestar të SNRF 9 mbi instrumentet financiarë është përshkruar në Shënimin 6. Për shkak të metodës së tranzicionit të zgjedhur, informacioni krahasues nuk është riparaqitur për të pasqyruar kërkesat e reja.

### (a) Transaksionet në monedhe të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksioneve. Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj në datën e raportimit janë ri-konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të shprehura në monedha të huaja që maten me vlerën e drejtë, konvertohen në monedhën funksionale në kursin e këmbimit në datën kur përcaktohet vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë që maten në bazë të kostos historike në një monedhë të huaj janë përkthyer duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat në valutë të huaj që rrjedhin nga përkthimi njihen në fitim ose humbje.

### (b) Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga administrimi përfaqësojnë tarifën e menaxhimit të asetëve dhe konsiderohet si e ardhur nga shërbimet lidhur me Fondet e Pensioneve/ Investimeve që Shoqëria ka në menaxhim. Shoqëria sillet si agjent kur siguron shërbimin e menaxhimit të asetëve.

Tarifat e shërbimit të menaxhimit të asetëve llogariten sipas një përqindje fikse të vlerës neto të asetëve të menaxhuara (shih Shënimin 15 për detaje). Prandaj, kjo konsideratë është variable. Natyra e secilës prej rrjedhave të të ardhurave të Shoqërisë së rezulton në një detyrim të vetëm të performancës: menaxhimin e asetëve. Kështu, Shoqëria nuk ka bërë gjykime të rëndësishme me alokimin e cmimit të transaksionit të detyrimit të performancës.

Tarifat e menaxhimit njihen përgjatë kohës që shërbimi sigurohet. Përkatësisht, të ardhurat njihen cdo ditë si një përqindje fikse (përqindje ditore) e vlerës neto të aseteve për secilin nga fondet e administruara që prej një date të caktuar. Shumat janë zakonisht të pagueshme Brenda 30 ditësh duke ia ngarkuar llogarisë së fondit përkatës. Meqë të ardhurat njihen si shuma e llogaritjeve të përditshme, nuk nevojiten rregullime në fund të periudhës.

Sipas Ligjit të Fondit të Pensioneve, pjesëtarët e fondit që vendosin të tërheqin fondet përpara limitit kohor të parashkruar në ligj, i nënshtrohen penaliteteve (një % e paracaktuar e vlerës neto të aseteve). Të ardhura nga penalitete të tilla njihen kur ndodh një tërheqje e parakohshme. Kjo e ardhur paraqitet si një rresht i vecantë në pasqyrën e fitimit/ humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse nën emrin "Të ardhura nga tërheqjet".

### **(c) Interesi**

#### *Norma efektive e interesit*

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma efektive e interesit është norma që skanton ekzaktësisht pagesat e ardhshme të parashikuara përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar me:

- Vlerën e mbetur bruto të aktivit; ose
- Koston e amortizuar të detyrimit financiar.

Kur llogaritet norma efektive e interesit për instrumentet financiare përveç aktiveve të provigjonuara, Shoqëria parashikon flukset e ardhshme duke konsideruar kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo gjithë humbjet.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin kostot e transaksionit, tarifat dhe pikat e paguara ose të përfituara që janë një pjesë thelbësore e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot në rritje që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të një aktivi ose detyrimi financiar.

#### *Kostoja e amortizuar dhe vlera e mbetur bruto*

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është shuma me të cilën ky aktiv ose detyrim matet në njohjen fillestare, minus pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të cdo difference mes shumës fillestare të njohur dhe shumës së maturuar.

'Vlera e mbetur bruto e një aktivi financiar' është kosto e amortizuar e një aktivi financiar përpara rregullimit për humbjet e pritshme.

#### *Llogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve të interesit*

Për të llogaritur të ardhurat dhe shpenzimet e interesit, norma efektive e interesit aplikohet mbi vlerën e mbetur bruto të asetit.

#### *Prezantimi*

Të ardhurat nga interesi prezantohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me koston e amortizuar të llogaritur mbi bazën e interesit efektiv.

### **(d) Shpenzime operative**

Shpenzimet operative njihen në momentin kur ndodhin.

### **(e) Qiraja**

#### *(i) Shoqëria si qiramarrës*

Kontratat e qirasë për zyra negocohen tipikisht për periudha 1 deri në 10 vjetare. Shoqëria nuk përfshihet në marrëveshje shitje dhe ridhënie me qira. Shoqëria vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira në pikënisje të kontratës. Një qira mbart të drejtën e drejtimit të përdorimit dhe marrjes së gjithë përfitimeve ekonomike të një aktivi të identifikuar për periudhën e zgjatjes së kontratës.

Disa kontrata qiraje përmbajnë komponentë qiraje dhe jo-qiraje. Komponentët e jo-qirasë lidhen me facilitetet e shërbimit të menaxhimit. Shoqëria ka zgjedhur të mos i ndajë qiratë për zyra në komponentët e lartpërmendur.

#### *(ii) Matja dhe njohja e qirave si qiramarrës*

Në datën e nisjes së qirasë, Shoqëria njih një aktiv dhe një detyrim qiraje përkatës në gjithë marrëveshjet ku është qiramarrës, përveç qirave afatshkurtra (më pak se 12 muaj) dhe qiratë me vlerë të ulët (si tableta, kompjuter personal, telefona, etj). Për këto qira, Shoqëria njih pagesat e qirasë si shpenzim operativ me bazë lineare përgjatë kohës së qirasë.

Aktivi në përdorim matet me kosto, që përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, cdo kosto direkte e pësuar



## 7. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

nga Shoqëria, një përfrim i kostos për të hequr aktivin në fund të qirasë dhe cdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë.

Shoqëria e zhvlerëson aktivin me bazë linare nga data e nisjes së qirasë deri në fund të jetës së vlefshme. Shoqëria gjithashtu vlerëson aktivin për provigjon kur ka indikatorë të tillë. Në datën e fillimit, Shoqëria mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të pakryera në atë datë, skontuar me normën e huamarrjes së Shoqërisë. Norma e huamarrjes së Shoqërisë është norma që Shoqëria do të duhet të paguante për të marrë hua të njëjtën shumë me kushte të ngjashme dhe sigur të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit përbëhen nga pagesa fikse, pagesa variable të bazuara mbi një indeks ose normë, shuma që pritet të jenë të pagueshme nën një vlerë garancie dhe pagesa që lindin nga opsione të logjikshme për t'u ushtruar.

Aktivitet në përdorim prezantohen me aktivet materiale në bilanc (shih Shënimin 11). Detyrimet e qirasë paraqiten në një rresht të vecantë në bilanc.

### (f) Përfitimet e punonjësve

#### (i) Planet e kontributeve të përcaktuara

Detyrimet për planet e kontributeve njihen në humbje ose fitim, pasi shërbimi përfshihet në shpenzime stafi.

#### (ii) Fondet shoqërore, të pensionit dhe shëndetit

Shoqëria derdh kontribute të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore në një fond të drejtuar nga shteti shqiptar. Detyrimet për këtë fond njihen në fitim ose humbje dhe përfshihen në shpenzime stafi.

#### (iii) Leje vjetore e paguar

Shoqëria njih si detyrim shumë të zbritur të kostove të llogaritura për lejen vjetore, që pritet të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e kryer.

#### (iv) Përfitime afatshkurtra

Përfitimet afatshkurtra të punonjësve maten në bazë jo të zbritshme dhe shpenzohen ndërkohë që sigurohet shërbimi. Njihet një provigjon për shumë që pritet të paguhet nën bonusin afatshkurtër nëse Shoqëria ka një detyrim të paguajë këtë shumë si rezultat i një shërbimi të kryer nga punonjësi në të shkuarën dhe mund të matet në mënyrë të besueshme.

### (g) Shpenzimet për tatimin e të ardhurave

Shpenzimet për tatimin e të ardhurave përbëhen nga taksat aktuale dhe të shtyra. Njihet në fitim ose humbje përveç nëse lidhet me zëra të kapitalit ose zëra të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

#### Taksat aktuale

Taksat aktuale përbëhen nga taksat e pagueshme ose të arkëtueshme mbi fitimin ose humbjen e tatueshme për vitin dhe rregullimet e taksave të pagueshme ose të arkëtueshme të vitit paraardhës. Shuma e taksës së pagueshme ose të arkëtueshme është përfrimi më i mirë i shumës që pritet të paguhet ose të përfitohet që reflekton pasiguri lidhur me taksat mbi të ardhurat, nëse ka.

## (h) Instrumentat financiarë

### (i) Njohja dhe matja fillestare

Shoqëria njeh aktivet dhe detyrimet financiare përmes në datën e tregëtimit, e cila është data kur Shoqëria bëhet palë e provizionit kontraktual të instrumentit. Aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen në datën kur ato krijohen. Një aktiv financiar ose detyrim financiar, në njohjen fillestare do të matet me vlerën e drejtë të tij plus, në rastin e elementëve të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, koston e transaksionit që i ngarkohet drejtpërdrejt blerjes ose emetimit.

Aktivtë financiarë, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtës, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Me kosto të amortizuar
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Klasifikimi përcaktohet nga:

- modeli i biznesit i njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivitetit financiar
- karakteristikat e flukseve të parasë kontraktuale të aktivitetit financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me aktivet financiare që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të shpenzimeve zhvlerësimit të të arkëtueshmet tregtare të cilat përfshihen brenda shpenzimeve të tjera.

### (ii) Klasifikimi dhe matja e mëpasshme

#### Aktivtë Financiare

Në njohjen fillestare, aktivi financiar klasifikohet si i matur me koston e amortizuar ose me VDAGJ. Aktivtë financiarë nuk riklasifikohen pas njohjes fillestare, përveç nëse Shoqëria ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare, në këtë rast të gjitha aktivtë financiarë të ndikuara riklasifikohen në ditën e parë të periudhës së parë raportuese pas ndryshimit në modelin e biznesit.

#### Vlerësimi i modelit të biznesit

Shoqëria vlerëson objektivat e modeleve të biznesit sipas të cilave menaxhohet një aktiv në nivel portofoli sepse kjo reflekton mënyrën më të mirë sesi menaxhohet biznesi dhe si informacioni i paraqitet drejtimit. Informacioni i vlerësuar përfshin:

- politikat dhe objektivat e përcaktuara të portofolit dhe zbatimi i tyre në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e drejtimit fokusohet në përfitimin e të ardhurave kontraktuale nga interesi, mbajtjen e një profili të veçantë të normës së interesit, përputhjen e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto aktive ose realizimin e flukseve të parasë nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- si vlerësohet performanca e portofolit dhe si i raportohet kjo performancë e drejtimit;
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modeleve të biznesit (dhe të aktiveve financiare të mbajtura brenda këtij modeli biznesi) dhe si menaxhohen këto rreziqe;
- si kompensohen menaxherët e portofoleve - p.sh. nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të aktiveve të menaxhuara ose në flukset të parasë kontraktuale të mbledhura; dhe
- frekuencën, volumin dhe kohën e shitjeve për periudhat e kaluara, arsyet e të tilla shitjeve dhe pritshmëritë për aktivitetin e ardhshëm të shitjeve. Megjithatë, informacioni mbi shitjet nuk merret parasysh i izoluar, por si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm se si arrihen nga Banka objektivat e përcaktuara për menaxhimin e aktiveve financiare dhe si realizohen flukset të parave të ardhshme.

Transferimi i aktiveve financiare me palë të treta me anë të transaksioneve që nuk i plotësojnë kushtet për çregjistrim, nuk konsiderohen shitje për këtë qëllim, në përputhje me njohjen në vazhdimësi të aktiveve të Shoqërisë. Shoqëria ka përcaktuar se ka një model biznesi që përfshin investimet në letrat me vlerë dhe investimet në fondet e investimeve të palistuar. Këto mjete financiare menaxhohen dhe performanca e tyre vlerësohet, në bazë të vlerës së drejtë, me shitjet e shpeshta që ndodhin.

#### Vlerësimi nëse flukset të parave kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit ("VPPI)

Për qëllim të këtij vlerësimi, 'principal' është vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare. 'Interesi' është shpërblimi për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kredisë të lidhur me shumën e principalit të pushlyer gjatë një periudhe kohore të caktuar, për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të kreditimit (p.sh. rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), duke përfshirë gjithashtu marzhin e fitimit.

## 7. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### H. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)

Për të vlerësuar nëse flukset e parave kontraktuale janë pagesa vetëm të principalit dhe interesit, Shoqëria merr parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse një aktiv financiar përmban një element kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve të pavare kontraktuale në mënyrë të tillë që nuk plotëson kushtin. Gjatë vlerësimit, Shoqëria konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që mund të ndryshojnë kohën dhe shumën e flukseve të parasë;
- kushte që mund të ndryshojnë normën kontraktuale të interesit, përfshirë normat e ndryshueshme;
- parapagimet dhe kushtet e shtyrjes; dhe
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Shoqërisë për flukset e parave nga aktive të caktuara (tipare të pakthyeshme)

Një tipar parapagimi është në përputhje me kushtin e pagesës vetëm për principalin dhe interesin nëse shuma e parapaguar në thelb paraqet shumën e papaguar të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar, të cilat mund të përfshijnë kompensim të arsyeshëm shtesë për ndërprerjen e hershme të kontratës. Gjithashtu, për një aktiv financiar të blerë me zbritje apo me prim mbi shumën kontraktuale, një tipar që lejon ose kërkon parapagim për një shumë që në thelb paraqet shumën kontraktuale plus interesa kontraktuale të përlllogaritur (por të papaguar), interes kontraktual (që mund të përfshijë dhe shpërblim për përfundim të parakohshëm) trajtohet si të jetë në përputhje me këtë kriter nëse vlera e drejtë e tiparit të parapagimit është e parëndësishme në njohjen fillestare.

#### *Aktivet financiare- Klasifikimi, matja e mëpasshme dhe fitimet dhe humbjet*

Shoqëria njeh Aktivet e veta financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar kur njësi bëhet palë e provizionimit kontraktual të instrumentit gjatë blerjes së rregullt të aktivit. Mënyra e rregullt e blerjes apo shitjes së aktivit financiar regjistrohet dhe c'rrregjistrohet, si e zbatueshme, duke përdorur datën kontabël të shlyerjes. Data e shlyerjes është data në të cilën aktivi dorëzohet nga ose tek një njësi. Data kontabël e shlyerjes referohet (a) njohjes së një aktivi në ditën e marrë nga njësi dhe (b) c'rrregjistrimi i një aktivi dhe njohja e cdo fitimi ose humbjeje mbi nxjerrjen në ditën gjatë së cilës është dorëzuar nga njësi. Kur data kontabël e shlyerjes aplikohet, njësi llogarit për cdo ndryshim në vlerën e drejtë të aktivit

që pritet të merret gjatë periudhës nga data e tregëtimit deri në datën e shlyerjes në të njëjtën mënyrë sic llogaritet për aktivin e blerë. E thënë ndryshe, ndryshimi në vlerën e drejtë nuk njihet për aktivet e matura me kosto ose kosto të amortizuara; njihet në fitim ose humbje për aktivet e klasifikuara si aktive

financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes; dhe njihet tek të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse për aktivet e klasifikuara si të vlefshme për shitje.

#### *Detyrimet financiare - Klasifikimi, matja e mëpasshme dhe fitimet dhe humbjet*

Detyrimet financiare klasifikoheshin si të matura me koston e amortizuar dhe pas njohjes fillestare ato mateshin me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet e interesit dhe

fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njiheshin në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose në humbje.

#### *(iii) Çregjistrimi*

##### *Aktivet financiare*

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit të gjithë rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivit financiar.

Shoqëria bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen.

##### *Detyrimet financiare*

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë. Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe flukset e parave të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet, një detyrim i ri financiar i bazuar në kushtet e modifikuar, njihet me vlerën e drejtë.

Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca midis vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë çdo aktiv financiar të transferuar apo detyrime të marra) njihet në fitim ose humbje.

#### *(iv) Kompensimi (netimi)*

Aktivt dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtë ligjore për të shlyer shumën dhe ka për qëllim të shlyejë ato në baza neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

*(v) Modifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare*

*Aktive financiare*

Nëse kushtet e një aktivi financiar modifikohen, Shoqëria vlerëson nëse flukset e parasë të aktivitetit të modifikuar janë thelbësisht të ndryshme.

Nëse flukset e parasë janë thelbësisht të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale për flukset e parasë nga aktivi financiar fillestar konsiderohen se kanë skaduar. Në këtë rast, aktivi financiar origjinal çregjistrohet (shih (iii)) dhe një aktiv financiar i ri njihet me vlerën e drejtë.

Nëse flukset e parasë të aktivitetit të modifikuar, të matur me kosto të amortizuara nuk janë thelbësisht të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në çregjistrimin e aktivitetit financiar. Në këtë rast, Shoqëria rillogarit vlerën kontabël bruto të aktivitetit financiar dhe një shumën që vjen nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si fitim ose humbje nga modifikimi në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Nëse një modifikim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit (shih (vii)), atëherë fitimi ose humbja paraqiten së bashku me humbjet nga zhvlerësimi. Në raste të tjera, ajo paraqitet si e ardhur nga interesi (shih 8(c)).

*Detyrimet financiare*

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar, kur kushtet e tij janë modifikuar dhe flukset e parasë të tyre janë thelbësisht të ndryshme. Në këtë rast njihet një detyrim i ri financiar me vlerë të drejtë bazuar në kushtet e modifikuara. Diferenca midis vlerës kontabël të aktivitetit që çregjistrohet dhe detyrimit të ri financiar me terma të modifikuara njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Nëse modifikimi i një detyrimi financiar nuk njihet si çregjistrim, atëherë kostoja e amortizuar e detyrimit rillogaritet duke skontuar flukset e parasë të modifikuara me normën fillestare të interesit efektiv dhe fitimi ose humbja që rezulton njihet në fitim ose humbje.

*(vi) Matja e vlerës së drejtë*

'Vlera e drejtë' është çmimi që do të arkëtohej nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes në një treg kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm tek i cili Shoqëria ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një pasivi pasqyron rrezikun e tij të mosekzekutimit.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është normalisht çmimi i transaksionit - dmth. Vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë.

Kur është e mundur, Shoqëria mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet "aktiv", në qoftë se transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimet në vazhdimësi.

Nëse nuk disponohet një kuotim çmimi në një treg aktiv, atëherë Shoqëria përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vrojtueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave jo të vrojtueshme. Teknika e zgjedhur përmbledh të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të marrin në konsideratë për përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

Shoqëria njih transferimin ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese në të cilën ka ndodhur ndryshimi.

*(vii) Zhvlerësimi*

Shoqëria njih një zbritje për HPK për aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar dhe e mat zbritjen në një shumë të barabartë me totalin e HPK përgjatë jetës së aktivitetit, përveç letrave me vlerë për për të cilat llogariten me HPK 12-mujore.

Shoqëria e konsideron një aktiv financiar në rrezik mosshlyerje kur:

- kundërpartia ka pak gjasa të paguajë detyrimet e plota ndaj Shoqërisë pa masa shtrënguese nga ana e Shoqërisë siç është realizimi i garancisë (nëse ka një të tillë) ose;
- pagesat për aktivin financiar janë vonuar më tepër se 90 ditë.

HPK-të 12-mujore janë ato pjesë të HPK-ve që rezultojnë nga ngjarjet e dështimit, që janë të mundshme të ndodhin brenda 12 muajve nga data e raportimit. Instrumentet financiare për të cilat njihet HPK 12-mujore referohen si 'Instrumente financiare në Fazën 1'.

HPK përgjatë gjithë jetës së aktivitetit janë HPK që rezultojnë nga ngjarjet që mund të ndodhin gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar. Periudha maksimale e konsideruar gjatë vlerësimit të HPK është periudha maksimale kontraktuale gjatë së cilës Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë.

*Matja e HPK*

HPK maten si mesatare e ponderuar sipas probabilitetit të ndodhjes së humbjeve të kredisë. Humbjet kreditore

## 7. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### H. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)

janë vlera aktuale e diferencave në flukset e parasë (diferenca mes flukseve të parave që duhet t'i paguhen Shoqërisë në përputhje me kontratën dhe flukseve të parave që Shoqëria pret të marrë).

HPK skontohen duke përdorur normën efektive të aktivitetit financiar.

#### *Aktivitetet financiare të zhvlerësuar*

Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse aktivitetet financiare të matura me koston e amortizuar janë aktive financiare me kredit të zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet me kredit të zhvlerësuar kur ka ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë një ndikim të dëmshëm në flukset e parasë të ardhshme të vlerësuar të aktivitetit financiar. Dëshmia se një aktiv financiar shfaq kredit të zhvlerësuar përfshin të dhënat e mëposhtme të vrojtueshme:

- vështirësi të konsiderueshme financiare të debitorit;
- shkelje të kontratës si dështimi ose mospagimi në afat;
- mundësinë që debitori të hyjë në falimentim ose ndonjë riorganizim tjetër financiar; dhe
- zhdukjen e një tregu aktiv për një letër me vlerë për shkak të vështirësive financiare.

Në kryerjen e vlerësimit nëse një investim në letra me vlerë është me kredit të zhvlerësuar, Shoqëria konsideron faktorët e mëposhtëm:

- Vlerësimin e tregut për cilësinë e kreditit, siç pasqyrohet në normat e kthimit të obligacioneve;
- Aftësinë e vendit për të hyrë në tregjet e kapitalit për emetimin e borxhit të ri;
- Mundësinë e ristrukturimit të borxhit, duke rezultuar në humbje për mbajtësit, nëpërmjet faljes vullnetare ose të detyrueshme të borxhit; dhe
- Mekanizmat ndërkombëtarë të mbështetjes që ekzistojnë për të siguruar mbështetjen e nevojshme si 'huadhënës i fundit në radhë' për atë vend, si dhe qëllimin e reflektuar në deklaratat publike, të qeverive dhe agjencive të këtyre vendeve për përdorimin e mekanizmave të tillë. Kjo përfshin një vlerësim të thellësisë së këtyre mekanizmave dhe pavarësisht nga qëllimi politik nëse ka kapacitet për të përmbushur kriteret e kërkuara

#### *Paraqitja e provizionit për HPK në pasqyrën e pozicionit financiar*

Humbjet për aktivitetet financiare të matura me koston e amortizuar zbriten nga vlera kontabël bruto e aktiveve.

#### *(viii) Fshirja*

Vlera kontabël bruto e një aktiviteti financiar fshihet kur Shoqëria nuk ka pritshmëri për rikuperimin e plotë ose të pjesshëm të aktivitetit financiar.

### **(i) Paraja dhe ekuivalentët e saj**

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë aktive financiare mjaft likuidë me maturitet tre muaj ose më pak nga data e blerjes, të cilat janë subjekt i një risku jo të rëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e drejtë, dhe përdoren nga Shoqëria për menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

### **(j) Aktivitetet materiale**

#### *Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve materiale maten me koston minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga provigjonimi, nëse ka.

#### *Kostot pasuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të aktivitetit material njihet në vlerën e mbetur të zërit nëse është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike do t'i rrjedhin Shoqërisë dhe kostot mund të maten në mënyrë të besueshme. Vlera e mbetur e pjesës së zëvendësuar creggjistrohet. Kostot e shërbimit të përditshëm të aktiveve materiale njihen në fitim ose humbje.

#### *Amortizimi*

Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën e reduktimit të balancës. Normat e amortizimit vjetor janë si në vijim: Pajisje zyre: 20%; Pajisje IT: 25%; Mjete: 20%.

Amortizimi llogaritet duke aplikuar normën e amortizimit përkatës mbi balancën hapëse të aktivitetit në vitin e dhënë financiar. Nëse aktivitetet shtohen në kategori gjatë vitit financiar, amortizimi llogaritet për muajt e mbetur të vitit.

### **(k) Aktivitetet jomateriale**

Aktivitetet jomateriale të blera nga Shoqëria njihen me koston minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Shpenzimet e mëtejshme mbi aktivitetet jomateriale kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme. Të gjithë zërat e tjerë janë shpenzime.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën e reduktimit të balancës. Norma e amortizimit vjetor është 25%.

## 8. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ

Paraja dhe ekuivalentët e saj përbëhen nga llogari rrjedhëse të mbajtura në Banka vendase dhe të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Llogari në bankë	30,468,391	29,099,677
Depozita në lek me maturim me pak se 3 muaj	550,039,178	640,000,000
<b>Total</b>	<b>580,507,569</b>	<b>669,099,677</b>

Në datë 31 dhjetor 2021 dhe 2020 depozitat janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Data e vendosjes	6 dhjetor 2021	3 dhjetor 2020
Data e maturimit	6 janar 2022	7 janar 2021
Norma e interesit	0.10%	0.10%

Depozitat dhe llogaritë afatshkurtra mbahen në Raiffeisen Bank Albania sha (kompania mëmë). Shoqëria nuk llogarit Humbjet e Pritshme nga Kredia, pasi periudha e maturimit është deri në një muaj dhe efekti është jomaterial.

## 9. LLOGARI TË ARKËTUESHME NGA FONDET

Shumat e arkëtueshme nga fondet i përkasin komisioneve të administrimit për muajin dhjetor të pagueshme nga secili prej Fondeve nën Administrimin e Shoqërisë, si dhe penaliteteve për tërheqje të parakohshme nga Fondi i Pensionit Vullnetar dhe janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Të arkëtueshme nga fondi i Investimit Prestigj	45,643,331	44,872,829
Të arkëtueshme nga fondi i Investimit Vizion	16,793,764	13,847,185
Të arkëtueshme nga fondi i Investimit Euro	9,012,354	11,166,386
Penalitete për tërheqje të parakohshme nga Fondi Pensionit Vullnetar	1,612,930	4,057,190
Të arkëtueshme nga fondi i Pensionit Vullnetar	1,290,861	1,107,506
Të arkëtueshme nga fondi i Investimit Miks	576,230	-
<b>Total</b>	<b>74,929,471</b>	<b>75,051,095</b>

## 10. INVESTIME TË MBAJTURA DERI NË MATURIM

	31 dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Vlera nominale	22,000,000	16,000,000
Interesi i përlllogaritur	226,722	145,920
Skonto/Prim i paamortizuar	-	1,584
<b>Total</b>	<b>22,226,722</b>	<b>16,147,504</b>

Investimet përbëhen obligacion 2-vjecare në Lek të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me normë kuponit 2.65%. Kuponi paguhet cdo 6 muaj për cdo obligacion.

## 10. INVESTIME TË MBAJTURA DERI NË MATURIM (VAZHDIM)

	Vlera nominale	Skonto/Prim i paamortizuar	Interesa të përlogaritura	Vlera kontabël
Obligacione qeveritare	22,000,000	-	226,722	22,226,722
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>22,000,000</b>	<b>-</b>	<b>226,722</b>	<b>22,226,722</b>

	Vlera nominale	Skonto/Prim i paamortizuar	Interesa të përlogaritura	Vlera kontabël
Obligacione qeveritare	16,000,000	1,584	145,920	16,147,504
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>16,000,000</b>	<b>1,584</b>	<b>145,920</b>	<b>16,147,504</b>

Lëvizjet në vlerat nominale të investimeve të mbajtura deri në maturim paraqiten si me poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Më 1 janar	16,000,000	21,000,000
Të blera gjatë vitit	22,000,000	-
Të maturuara gjatë vitit	(16,000,000)	(5,000,000)
<b>Total</b>	<b>22,000,000</b>	<b>16,000,000</b>

## 11. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

	Automjete	Pajisje zyre dhe informatike	E drejtë përdorimi e asetit	Totali
<b>Kosto</b>				
<b>Gjendja më 1 janar 2020</b>	<b>12,042,093</b>	<b>15,113,317</b>	<b>3,954,408</b>	<b>31,109,819</b>
Shtesa	-	1,884,469	-	<b>1,884,469</b>
Pakësime	-	-	(3,954,408)	<b>(3,954,408)</b>
	<b>12,042,093</b>	<b>16,997,786</b>		<b>29,039,879</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>-</b>	<b>4,233,424</b>	<b>28,552,062</b>	<b>32,785,486</b>
Shtesa		-	-	<b>0</b>
Pakësime	12,042,093	21,231,210	28,552,062	<b>61,825,365</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>12,042,093</b>	<b>15,113,317</b>	<b>3,954,408</b>	<b>31,109,819</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>				
<b>Gjendja më 1 janar 2020</b>	<b>7,733,320</b>	<b>11,324,315</b>	<b>-</b>	<b>19,057,635</b>
Shpenzimi i vitit	861,636	1,048,548	3,954,408	<b>5,864,592</b>
Pakësime	-	-	(3,954,408)	<b>(3,954,408)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>8,594,956</b>	<b>12,372,863</b>	<b>-</b>	<b>20,967,819</b>
Shpenzimi i viti	689,308	1,531,163	1,427,603	<b>3,648,074</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>9,284,264</b>	<b>13,904,026</b>	<b>1,427,603</b>	<b>24,615,893</b>
<b>Vlera kontabel</b>				
<b>Më 1 Janar 2020</b>	<b>4,308,773</b>	<b>3,789,002</b>	<b>3,954,408</b>	<b>12,052,184</b>
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>3,447,137</b>	<b>4,624,923</b>	<b>-</b>	<b>8,072,060</b>
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>2,757,829</b>	<b>7,327,184</b>	<b>27,124,459</b>	<b>37,209,472</b>

Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 nuk ka aktive afatgjata materiale të vendosura si kolateral për kredi afatgjata ose afatshkurtra.



## 12. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE

	Programe Kompjuterike	Totali
<b>Kosto</b>		
<b>Gjendja më 1 janar 2020</b>	<b>25,132,635</b>	<b>25,132,635</b>
Shtesa	665,932	665,932
Pakësime	(130,159)	(130,159)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>25,668,408</b>	<b>25,668,408</b>
Shtesa	8,295,734	8,295,734
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>33,964,142</b>	<b>33,964,142</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>		
<b>Gjendja më 1 janar 2020</b>	<b>19,662,974</b>	<b>19,662,974</b>
Shpenzimi i vitit	1,543,470	1,543,470
Pakësime	(130,159)	(130,159)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>21,076,285</b>	<b>21,076,285</b>
Shpenzimi i viti	2,231,200	2,231,200
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>23,307,485</b>	<b>23,307,485</b>
<b>Vlera kontabël</b>		
<b>Më 1 janar 2020</b>	<b>5,469,661</b>	<b>5,469,661</b>
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>4,592,124</b>	<b>4,592,124</b>
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>10,656,658</b>	<b>10,656,658</b>

## 13. DETYRIME TË TJERA

Detyrime të tjera më 31 dhjetor 2021 dhe 2020, lidhur me aktivitetin operativ të Shoqërisë paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Detyrime për sponsorizime	17,227,893	6,397,574
Bonus i akumuluar për punonjësit	5,072,143	5,222,758
Shpenzime të përlogaritura auditimi	2,824,046	2,280,131
Furnitorë	714,899	21,345
Detyrime për sigurime shoqërore	570,000	480,125
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	519,411	440,271
Detyrime për Autoritetin e Mbikqyrjes	130,477	2,767,075
Detyrime ndaj bankës administruese	55,904	3,584,156
<b>Detyrime RBAL</b>	<b>96,900</b>	-
<b>Të tjera</b>	<b>436,378</b>	<b>221,395</b>
<b>Totali</b>	<b>27,648,051</b>	<b>21,414,830</b>

Detyrimet për sponsorizimet përfaqësojnë kontratat e firmosura për aktivitete të ndryshme sponsorizimi në kuadrin e përkushtimit të Shoqërisë ndaj përgjegjësive sociale, të cilat janë firmosur në 2021, por janë ende të papaguara në 31 dhjetor. Shoqëria paguan detyrimet për sponsorizime bazuar në dokumentat për punët e performuara. Në fund të vitit 2021 shumë kompani e kishin të pamundur të paraqisnin dokumenta justifikuesë dhe si rezultat balanca e këtij zëri rezultoi të ishte ndjeshëm më e lartë se në fund të 2020.

## 14. DETYRIMET E QIRASË

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
<b>Gjendja në 1 janar</b>	-	<b>3,954,408</b>
Shtesa	28,552,062	-
Shpenzime interesi	185,228	593,161
Pagesa qiraje	(1,105,160)	(3,361,247)
Efekti i përkthimit	(407,858)	-
<b>Gjendja në 31 dhjetor</b>	<b>27,224,272</b>	-
Korrente	2,892,366	-
Jo-korrente	24,331,906	-
<b>Totali</b>	<b>27,224,272</b>	-

Shumat e mëposhtëme janë shumat e paraqitura në fitim dhe humbje:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
<b>Gjendja në 1 janar</b>	-	<b>3,954,408</b>
Shpenzim amortizimi i të drejtës së përdorimit	1,427,603	593,161
Shpenzim interesi detyrim qiraje	185,228	-
Shpenzim qiraje afatshkurtër (shënim 19)	2,330,850	4,547,569
<b>Totali</b>	<b>3,943,681</b>	-

### Pagesa qiraje të ardhshme

Më 31 dhjetor, pagesat e ardhshme të qirasë nën qira të cilat nuk mund të anulohen ishin të pagueshme si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Më pak se 1 vit	3,002,577	-
1 – 5 vite	15,012,883	-
Më shumë se 5 vite	10,196,749	-
<b>Totali</b>	<b>28,212,209</b>	-
Shpenzim interesi	(987,938)	-
<b>Detyrim qiraje financiare</b>	<b>27,224,272</b>	-

Shih shënimin 20 (i) për pagesat e qirasë jo të zbritshme

## 15. KAPITALI AKSIONAR

Me 31 dhjetor 2021 dhe 2020, kapitali aksionar i regjistruar është 90,000,000 Lek i përbërë nga 12,857 aksione me vlerë nominale prej 7,000.08 Lek/aksion. Aksioneri i vetëm i Shoqërisë është Raiffeisen Bank sh.a. dhe aksioneri përfundimtar është Raiffeisen Bank International AG me seli në Vienë, Austri.

Referuar rezervës ligjore, bazuar në ligjin nr. 9901 datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë e tregtare" si dhe statutin e Shoqërisë, Shoqëria mban një rezervë ligjore dhe transferon cdo vit 5% te fitimit neto të realizuar në vitin financiar paraardhës derisa shuma të arrije 10% të vlerës së kapitalit. Duke qënë se rezerva ligjore ka arritur nivelin prej 10% të vlerës së kapitalit, nuk ka patur ndryshim të rezervës ligjore gjatë vitit 2021. Përdorimi i rezervave ligjore është në vullnetin e aksionereve të Shoqërisë.

Shoqëria menaxhon strukturën e kapitalit dhe si rezultat i ndryshimeve në kushtet ekonomike bën ndryshimet përkatëse. Për të mbajtur strukturën e duhur të kapitalit, Shoqëria mund të ndryshojë pagesat e dividendit ndaj aksionerëve ose t'u kthejë kapitalin aksionerëve. Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe atij të mbyllur më 31 dhjetor 2020, nuk janë bërë ndryshime në objektivat, rregullat dhe proceset në fuqi në këtë fushë.

Objektivi kryesor i menaxhimit të kapitalit të Shoqërisë është të mbajë raporte të sigurta të kapitalit që do të mbështesnin aktivitetin operativ të Shoqërisë dhe do të rrisnin vlerën për aksionerët e saj, duke iu përbajtur kërkesave të kapitalit të kërkuar me ligj.

Shoqëria duhet t'i përmbahet kërkesave të kapitalit në përputhje me Rregulloren nr. 132 "Mbi llogaritjen e formës dhe shumës minimale të fondeve të veta të detyrueshme për shoqëritë e administrimit të fondeve", 30 shtator 2020. Më 31 dhjetor 2021, minimumi i kërkuar i kapitalit duhet të jetë 30,635,990 ALL, kriter ky i përmbushur nga Shoqëria (kapitali ka shumën ALL 90,000,000, përjashtuar fitimin neto për 2021 dhe fitimin e pashpërndarë).

Për të marrë vendime për shpërndarjen e fitimit, Shoqëria performon aktivitetet e mëposhteme vendimtare për të formuar politikën e dividendit:

- Monitoron konformitetin me kërkesat e kapitalit,
- Llogarit nevojat shitesë për kapital në perspektivën e 12 muajve nga momenti i aprovimit të pasqyrave financiare, në mënyrë që pagesa e dividendit nga Shoqëria të mos ndikojë përmbushjen e kriterëve të kapitalit në muajt pasardhës.

## 16. TARIFA E ADMINISTRIMIT TË FONDEVE

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Raiffeisen Prestigj	548,247,166	522,060,841
Raiffeisen Vizion	186,496,979	153,663,974
<b>Raiffeisen Invest Euro</b>	<b>125,466,573</b>	<b>137,894,184</b>
<b>Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen</b>	<b>14,256,349</b>	<b>12,241,625</b>
<b>Raiffeisen Miks</b>	<b>4,234,783</b>	-
	<b>878,701,850</b>	<b>825,860,624</b>

Të ardhurat e administrimit të Fondeve llogariten mbi Vlerën Neto të Aktiveve ditore për secilin fond, bazuar në tarifën e përcaktuara, të detajuara si më poshtë:

- • Fondi Pretigj – 1.25% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve deri në 24.11.2021; Ndryshuar në 1.15% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve nga 25.11.2021 në 31.12.2021
- • Fondi Vizion – 1.25% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve deri në 24.11.2021; Ndryshuar në 1.15% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve nga 25.11.2021 në 31.12.2021
- • Fondi Pensionit – 1.5% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve
- • Fondi Raiffeisen Invest Euro – 1.5% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve deri në 24.11.2021; Ndryshuar në 1.15% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve nga 25.11.2021 në 31.12.2021
- • Fondi Miks – 1.3% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve.

Shpenzimi gjithashtu llogaritet në bazë ditore mbi Vlerën Neto të Aktiveve.

Fondi Prestigj, Vizion dhe Euro kanë aplikuar ndryshime në prospektin e Shoqërisë për t'iu përbajtur ligjit të ri të Mbledhjes së Sipërmarrjeve të Investimit.

Shoqëria nuk ka ndarë informacion mbi alokimin e çmimit të transaksionit për detyrimet e mbetura të performancës, sepse një përaftrim i çmimit të transaksionit do të përfshinte vetëm variablat e supozuar që janë të kufizuara.

## 17. TË ARDHURA NGA INTERESAT LLOGARITUR ME METODËN E INTERESIT EFEKTIV

Të ardhurat nga interesi i instrumentave financiare sipas kategorive përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Obligacione të qeverise	568,727	573,700
Depozita me afat dhe llogari rrjedhese	500,436	575,699
	<b>1,069,162</b>	<b>1,149,399</b>

## 18. SHPENZIME PERSONELI

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Paga, shpërblime	44,605,456	46,186,334
Sigurime shoqërore	3,787,521	3,586,254
Kosto të tjera të personelit	1,419,107	1,438,965
	<b>49,812,084</b>	<b>51,211,553</b>

## 19. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Shpenzime të tjera për menaxhimin e fondeve të investimit	373,293,950	313,745,100
Marketing dhe Sponsorizime	88,239,173	95,807,379
Shpenzime për bankën depozitare	39,933,444	41,615,840
Tarifë për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare	30,638,185	30,968,890
Shpenzime të shitjes me agjent	14,682,800	14,884,200
Shpenzime mirëmbajtje	13,038,256	10,098,440
Komisione transaksionesh të paguara për shoqërinë dhe fondet	10,639,360	11,259,747
Taksa	3,946,743	2,136,207
Shpenzime qiraje	2,330,850	-
Posta	910,701	-
Shpenzime telefonike dhe internet	241,810	251,407
Shpenzime të tjera stafi	138,486	53,300
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	129,483	59,152
Sigurime	108,390	114,257
Shpenzime noteri dhe ligjore	87,900	10,240
Të tjera	11,663,398	6,303,230
<b>Totali</b>	<b>590,022,929</b>	<b>527,307,388</b>

Tarifat e tjera të administrimit të fondeve lidhen me marrëveshjen e bashkëpunimit midis Raiffeisen Bank sh.a dhe Raiffeisen Invest sh.a të datës 3 janar 2013, sipas së cilës Raiffeisen Invest sh.a angazhohet të pajisë të gjithë investitorët me një paketë shërbimesh të Shoqërisë, të ofruara nga Raiffeisen Bank sh. dhe të mbulojë nëpërmjet pagesave mujore të gjitha kostot e shërbimeve të përfshira në paketë. Për vitin 2020 kostoja e shërbimeve të paketës është 950 Lek/për investitor (2019: 950 Lek/për investitor)

Shpenzime të shitjes me agjent lidhet me marrëveshjen e bashkëpunimit mes Raiffeisen Invest sha dhe Raiffeisen Bank sha, më datë 25 janar 2012 (ndryshimi i fundit dhjetor 2019) sipas së cilës Raiffeisen Invest sha bie dakord t'i paguajë Raiffeisen Bank sha tarifën vjetore të shitjes me agjent në këmbim të përpjekjeve dhe suksesit të kësaj të fundit për të shitur fonde investimi RIAL. Për vitin 2021 cmimi i shërbimeve është 120.000 Eur (2020 – 120.000 Eur).

Referuar zërit "Tarifë për Autoritetin e Mikëqyrjes Financiare", bazuar në rregulloren nr. 18/1, datë 15 shkurt 2010 të Bordit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (të rishikuar në 6 tetor 2011), shoqëritë e administrimit të fondeve të pensioneve dhe të investimeve duhet të paguajnë kundrejt Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare një tarifë vjetore prej 0,05% të vlerës së aktiveve në fund të muajit për fondet e investimeve dhe 0,05% të vlerës së aktiveve në fund të tremujorit për fondet e pensioneve). (2019: 0,05% të vlerës së aktiveve në fund të muajit për fondet e investimeve dhe 0,05% të vlerës së aktiveve në fund të tremujorit për fondet e pensioneve).

## 20. TATIM MBI FITIMIN

Shoqëria ka përcaktuar tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin shqiptar. Në 2021, norma e tatimit në Shqipëri është e barabartë me 15% (2020: 15%) e fitimit të tatueshëm. Më poshtë paraqitet rakordimi i tatimit mbi fitimin i përlogaritur me normën e aplikueshme të tatimit me fitimin kontabël:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
<i>Tatim fitimi korrent</i>	104,852,410	97,672,130
<i>Taksat e shtyra</i>	-	-
<b>Totali</b>	<b>104,852,410</b>	<b>97,672,130</b>

Rakordimi i mëposhtëm tregon marrëdhënien mes fitimit para dhe pas normës efektive të tatimit:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Fitimi para tatimit	235,452,754	242,196,716
Shpenzimi i tatim fitimit teorik duke përdorur normën 15%	35,317,913	36,329,507
<b>Efkti i tatimit:</b>		
Të ardhurat përjashtuar taksën	-	-
Shpenzime jo të zbritshme	69,534,497	61,342,623
Përdorimi i humbjeve nga tatimi të mbartur nga vitet e mëparëshme		
<b>Barra tatimore efektive</b>	<b>104,852,410</b>	<b>97,672,130</b>
<b>Barra tatimore efektive, %</b>	<b>44.53%</b>	<b>40.33%</b>

Në efektin tatimor të shpenzimeve të pazbritshme është përfshirë një shumë prej Lek 55,994,093 (2020: Lek 47,061,765) që lidhet me shpenzimet për shërbimet e marra nga Raiffeisen Bank sh.a.

## 21. INSTRUMENTET FINANCIARE VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT

### (a) Matja e vlerës së drejtë

Shoqëria i klasifikon aktivet dhe detyrimet financiare me kosto të amortizuara.

*Paraja dhe ekuivalentët e saj*

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë llogari rrjedhëse në bankat vendase. Duke qenë se këto balanca janë afatshkurtra, vlera e tyre e drejte është konsideruar e barabartë me vlerën e tyre të mbetur.

*Asetet financiare me kosto amortizuar*

Vlera e drejtë e aktiveve financiare me kosto të amortizuar është 22,428,872 ALL (2020:16, 347,456 ALL). Vlera e drejtë për këtë investim është llogaritur duke përdorur një model të skontimit të flukseve të parasë bazuar në një kurbë kthimi të përshtatshme për periudhën e mbetur të maturimit.

### (b) Administrimi i rrezikut financiar

Shoqëria është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivave të Shoqërisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe administrimin e rrezikut, si dhe menaxhimin e kapitalit të Shoqërisë.

#### **Struktura e administrimit të rrezikut**

Bordi i Administrimit ka përgjegjësinë e përgjithshme për krijimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë. Bordi është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë. Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë krijohen për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat ballafaqohet institucioni financiar, për të vendosur kufizimet dhe kontrollet e përshtatshme të rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Shoqërisë, përmes standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

#### **(i) Rreziku i kredisë**

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale. Për qëllime të raportimit për menaxhimin e rrezikut, Shoqëria konsideron këto elemente të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (të tilla si rreziku individual i rrezikut dhe rreziku i sektorit). Bordi i Administrimit të Shoqërisë ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e rrezikut të kredisë për Drejtimin, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë të Shoqërisë. Investimet e Shoqërisë janë në bono thesaru dhe obligacione të Qeverisë Shqiptare dhe për këtë arsye Shoqëria është e ekspozuar vetëm ndaj rrezikut të kredisë së qeverisë shqiptare. Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal të kredisë. Ekspozimi maksimal i kredisë ndaj rrezikut të kredisë në datën e raportimit ishte:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Paraja dhe ekuivalentët e saj	580,507,569	669,099,677
Aktive Financiare të mbajtura deri në maturim	97,156,193	91,198,599
<b>Totali</b>	<b>677,663,762</b>	<b>760,298,277</b>

**21. INSTRUMENTET FINANCIARE – VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)  
B. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë:**

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë për llogaritë e arkëtueshme në datën e raportimit sipas llojit të rajonit gjeografik ishte:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Vendase	677,663,762	760,298,277
<b>Totali</b>	<b>677,663,762</b>	<b>760,298,277</b>

Cilësia e kredisë së aktiveve financiare është si vijon:

	<b>2021</b>					<b>2020</b>
	<b>Niveli 1</b>	<b>Niveli 2</b>	<b>Niveli 3</b>	<b>POCI</b>	<b>Totali</b>	<b>Totali</b>
Qeveria e Republikës së Shqipërisë B+	22,226,722	-	-	-	22,226,722	16,147,504
Paraja dhe ekuivalentët e saj, te pa rankuara	580,507,569	-	-	-	580,507,569	669,099,677
Humbja nga zhvlerësimi	(40,711)	-	-	-	(40,711)	(12,145)
<b>Vlera kontabël</b>	<b>602,693,580</b>	-	-	-	<b>602,693,580</b>	<b>685,235,036</b>

*Investimet e letrave me vlerë*

Rreziku i kredisë së portofolit të letrave me vlerë të investimit vlerësohet në bazë të të dhënave historike dhe vlerësimit të aftësisë së qeverisë shqiptare për të përmbushur detyrimet e saj kontraktuale të flukseve të parasë në monedhën vendase në afatin e shkurtër.

Qeveria shqiptare është vlerësuar si B +, e qëndrueshme, bazuar në vlerësimin e Standard & Poor's dhe B1, të qëndrueshëm, bazuar në vlerësimin e Moody's.

*Paraja dhe ekuivalentët e saj*

